

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI  
Zv/kryeredaktor: Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7380 E hënë 11 Dhjetor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Letra

Ditës

Nga PROF. DR. SABRI LAÇI

Po tentohet të ndryshohet rezultati i votimit



Sabri Laçi, profesor në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës, i cili u shpall fitues për postin e dekanit pas përmbylljes së numërimit të votave...  
Vijon në faqe 18

Opinion

Ditës

Nga SHABAN MURATI

Kurthi i "formulës ukrainase" për Kosovën në OKB



Një burim diplomatik perëndimor nga Beogradi bën të ditur se qeveria serbe ka hartuar një plan të fshehtë për të kapërcyer kushtin e kushteve, që BE i ka vënë Serbisë...  
Vijon në faqen 19



Ish-themeluesja e PD-së, Natasha Lako

Ish-themeluesja: Gratë protestuan në '88-ën, më pas studentët

## Natasha Lako: Dreka në shtëpi me Berishën e shqetësimi një ditë pas rënies së bustit

"Debatet në '91, pse propozova Dritëroin kryetar Kuvendi. Flasin për 'pardesytë e bardha' dhe harrojnë xhupin e Azemit"

Paraardhësit e saj, Natasha Lakos i lanë trashëgimi dijen, kurse ajo mendoi për diçka edhe më të madhe, që fëmijët e saj e bashkëmohatarët e tyre në të gjithë Shqipërinë një ditë të mund të jetonin të lirë. Ndaj guxoi 27 vite më parë. Atë çfarë përjetoi gjatë periudhës së vështirë të rrëzimit të diktaturës...

Në faqet 4-5

## KESHILLI I MINISTRAVE: SI TE MARRESH TE DREJTEN PER TE KRYER PUNIME

# NDRYSHOJNE PROCEDURAT PER LEJET E NDERTIMIT

Vendimi i qeverisë, 11 llojet e punimeve që mund të kryeni në shtëpi dhe afatet që duhet të ndiqni me autorizimin për të kryer ndërhyrjet



(Në foto) Foto ilustruese

Në faqen 6

FLET AMBASADORJA VASAK

Franca: S' duhet të nxitohemi për hapjen e negociatave me Shqipërinë

Në faqen 3

HUMBJA, FLET ISH-DEPUTETI

Vrasja e Ndokës, leje djalit nga burgu për të marrë pjesë në varrim

Në faqen 7

DYSHIMET E POLICISE

Gjendet i djegur në ashensor vëzhguesi i FSHF-së. Qerim Ruçi, ditët e fundit të tij

Në faqen 12

VESHITIRESITE NE TREG

Studimi, Kosiqi: 60% e punësimeve bëhen me "mik", 15% e të diplomuarve të papunë

Në faqet 10-11

53 VJET ME PARE



Letërkëmbimi i panjohur i Agollit me Sadijen, Çfarë i shkruante ai gruas që kaloi jetën

Në faqet 8-9

Klevis Thomai: Kujdes nga "trupat e huaj" në rrugët ajro-ushqimore

## Ylli Merja: Si të kuroni infeksionet në fytyrë

Këshillat e mjekut popullor dhe bimët që duhet të përdorni

Nga VOLTIZA DURO

Në lëkurë ka gjëndra dhe pore, ku gjëndrat prodhojnë yndyrë, dhe nëse çekuilibrohet prodhimi i yndyrës, që vjen si shkak i çrregullimit hormonal, atëherë prodhon lëkurë më shumë yndyrë. Pastaj nga mungesa e higjienës...



nës në lëkurën e yndyrshme, ngjiten bakterie dhe mikroba nga ajri dhe shkaktojnë puçra. Infeksionet bakteriale mund të merren në sallonet e bukurisë, kur përdoren furça të njëjta dhe nuk dezinfektohen nga njëri person tek tjetri. Gjithashtu...

Suplement

**DREJTESIA**  
**DEBATI**

Nishani flet për një skandal me ligjin e pronave: Në Venecia ligji i rremë

# Basha thirrje shqiptarëve: Të fitojmë betejën për liri

"Rama po ju shkel me këmbë të drejtat tuaja"

Valentina Madani

Në ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, kryetari i Partisë Demokratike Lulzim Basha akuzon qeverinë dhe kryeministrin Edi Rama se po shkel të drejtat dhe liritë e qytetarëve shqiptarë përmes shit/blerjes së votës, shantazheve dhe kërcënimeve. Z.Basha iu ka bërë thirrje qytetarëve të bashkohen, duke e parë këtë garancinë e vetme të fitores në betejën për liri dhe të drejtat njerëzore. Sipas tij, fatkeqësisht shqiptarët ende nuk zgjedhin dot të lirë, nuk gëzojnë dot lirinë e plotë të fjalës nga censura e qeverisë, edhe pse 27 vite pas ardhjes së demokracisë. "Në 10 dhjetor 2017, Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, duhet të debatohim si shoqëri për të drejtat e grave, të fëmijëve, për të drejtat e të rinjve, për përmirësimin e kushteve ku secili të ushtronte dhe të gëzonte të drejtat që i takojnë. Por fatkeqësisht 27 vite pas ardhjes së demokracisë, ne shqiptarët ende nuk zgjedhim dot të lirë, nuk gëzojmë dot lirinë e plotë të fjalës nga censura e qeverisë mbi median, nuk përfitojmë dot nga liria e vërtetë e tregut prej monopoleve të pushtetit", - u shpreh kreu i PD-së. Sipas tij kanë kaluar 27 vite nga rënja e komunizmit, por liria e fjalës nuk është e plotë dhe mbi median po ushtrohet censurë nga qeveria. "Edi Rama i ka asgjësuar këto të drejta me shitblerjen e votës, me shantazhe dhe me kërcënime. Qeveria e tij e shkel përditë dinjitetin e qytetarëve me makutërinë e tenderëve e koncesioneve, me shpërdorimin që ju bën fondeve publike, me arrogancën ndaj njerëzve. Kjo qeveri njih vetëm privilegjet e saj, dhe shkel me këmbë të drejtat e liritë e njerëzve të



Kryetari i Partisë Demokratike Lulzim Basha

**Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut**

**Meta: Fjalët që edhe sot tingëllojnë aktuale**

Presidenti Ilir Meta në Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, rikujtoi Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, si kushtetuta e parë universale në mbarë botën, e cila sipas tij tingëllojnë edhe sot aktuale. "Më 10 dhjetor 1948, u miratua Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, kushtetuta e parë universale në mbarë botën. Njohja e dinjitetit të lindur të të drejtave të barabarta dhe të patjetrueshme të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore është themel i lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë; mosrespektimi dhe përbuzja e të drejtave të njeriut çon drejt veprimeve barbare, që fyjnë ndërgjegjen njerëzore dhe krijimi i një bote në të cilën njerëzit do të gëzojnë lirinë e fjalës, lirinë e besimit dhe lirinë nga frika dhe skamja është shpallur si aspirata më e lartë e çdo njeriu", janë fjalët e para të këtij dokumenti thellësisht emancipues, të cilat edhe sot tingëllojnë aktuale dhe u kërkohen ende shteteve dhe qeverive, organizatave ndërkombëtare, shoqërisë civile dhe vetë individëve të rikthejnë jo vetëm kujtesën, por edhe vëmendjen dhe energjitë e tyre në respekt parimeve detryruese të saj", shprehet kreu i shtetit, Ilir Meta.



thjeshtë. Bashkimi i të gjithë shqiptarëve është garancia e fitores në betejën për liri dhe të drejtat njerëzore", - u shpreh z.Basha.  
**SKANDALI**  
Ish-presidenti i Republikës Bujar Nishani, në Ditën Ndërkombëtare të të

**THIRRJA**  
"Kjo qeveri njih vetëm privilegjet e saj, dhe shkel me këmbë të drejtat e liritë e njerëzve të thjeshtë. Bashkimi i të gjithë shqiptarëve është garancia e fitores në betejën për liri dhe të drejtat njerëzore", - u shpreh z.Basha.

**PPE: Hyrja në BE përmes zbatimit të ligjit**

Presidenti i Partive Popullore Evropiane, Joseph Daul, i kujtoi dje qeverisë shqiptare se për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian duhet zbatuar ligji dhe duhet goditje e fortë ndaj krimit të organizuar. Z.Daul me anë të postimeve të tij në "Twitter" ka dhënë mendimin e tij për Shqipërinë. Sipas tij droga dhe krimi janë problem për zhvillimin e Shqipërisë. "Krimi dhe droga në Shqipëri janë një problem i madh që pengon rrugën e Evropës. Përpjekje reale duhet të bëhen për të luftuar këto krime me transparencë të plotë", -ka qenë ky postimi i parë i Joseph. Po më pas ai ka bërë sërish një postim ku shkruan: "Aspiratat për Bashkimin Evropian të Shqipërisë do të jenë vetëm kur të ketë sundim të ligjit, të zbatohet pavarësisht e drejtësisë dhe lufta kundër korrupsionit".



Gjatë një seance parlamentare

**SUPER-AGJENCIA E RAMËS**

**PD, Hasa: Qeveria i hap rrugë koncesionit multimilioner**

PD hodhi dje akuzat ndaj kryeministrit Rama, referuar një vendimi të qeverisë, marrë pak kohë më parë, mbi administrimin e të gjitha sistemeve elektronike nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, e cila ishte dhe super-agjencia e parë e qeverisë "Rama 2". Për PD kjo agjenci është një "Big Brother" i krijuar nga Rama për të vënë në kontroll të gjitha të dhënat e shqiptarëve, si dhe të veprojë pa lënë gjurmë në çdo sistem elektronik në vend. Deputeti Endri Hasa deklaroi në një dalje për media se kjo agjenci vepron si koordinuese dhe mbikëqyrëse e veprimeve në sistemet elektronike, ndër mjet institucioneve qeveritare, ndërsa me vendimin e Këshillit të Ministrave, AKSHI do të jetë njësoj si "Big Brother". Merr nën kontroll të gjithë infrastrukturën dhe stafin teknik në të gjithë vendin! "Me ligj, duhet që DSIK-ja, përgjegjëse edhe për vetingun, të ketë kontroll mbi njerëzit dhe sistemet me informacione sensitive, përfshirë ato të AKSHI-t. Pse i duhet "Big Brother"-i, një agjenci civile, të marrë kontrollin e sistemeve të Ministrisë së Mbrojtjes të një vendi anëtar të NATO-s? Të gjithë e mbajmë mend skandalin e kopjimit dhe fshirjes së të dhënave nga serveri i Tatimeve 4 vjet më parë. Vepërimi u zbulua, sepse la gjurmë. Por tani "Big Brother" është vetë edhe të serveri i Tatimeve, edhe të sistemi i gjurmëve", -deklaroi deputeti Hasa.



përmasa të mëdha. "E drejta e pronës në Shqipëri tani gjykohet sipas një ligji, vlerësimi për të cilin nga Komisioni i Venecias është bërë mbi një version të falsifikuar dërguar nga institucionet e shtetit shqiptar", - u shpreh z.Nishani. Sipas tij, ky skandal "i përmasave të mëdha" nuk do mund të harrohet lehtë. "Por ai bën me turp autoritetet më të larta të drejtësisë shqiptare dhe komprometon seriozitetin e individëve të përfshirë në opinionin e Venecias", -deklaroi z.Nishani.



**Akuza e LSI: Kriminelët u bënë njësh me krimin**

**Vasili-Ramës: Zhveshe policinë për vota, prokuroria faj të rëndë**

Kreu i Grupit Parlamentar të LSI, Petrit Vasili akuzoi dje se kryeministri Edi Rama zhveshi policinë për vota, ndërsa sipas tij, heshtja e prokurorisë për këtë çështje është një faj i rëndë publik. Shprehet se ambasadorët nuk folën dhe OSBE nuk e dënoi publikisht dhe fort rastin. Në videon e publikuar nga Vasili drejtohet thirrja e Ramës për policinë gjatë fushatës së zgjedhjeve. "Kryeministri zhveshi policinë për vota, heshtja e prokurorisë faj i rëndë publik. Në fushatën e zgjedhjeve të qershorit kryeministri i kërkoi policisë të flakë uniformën dhe të bënte vota për Partinë Socialiste.



Kreu i Grupit Parlamentar të LSI, Petrit Vasili

Ambasadorët e huaj që s'lënë gjë pa komentuar nuk folën. As OSBE nuk e dënoi publikisht dhe fort. Në fund të fundit ky hall shumë i rëndë është yni se

qytetarët mbetën pa shtet dhe policë e kriminelë u bënë njësh me krimin", tha z.Vasili. Ai akuzoi se: "Prokuroria hesht edhe sot e kësaj dite, megjithëse është denoncuar ky kryeministër dhunues i ligjit, ndërkohë që

qindra punonjës të thjeshtë kanë humbur punën dhe ndiqen penalisht vetëm për pjesëmarrje në aktivitetet elektorale. Kjo heshtje është faj i rëndë publik. A ka frikë prokuroria nga kryeministri, kur fajin e ka

**PETRIT VASILI**  
"Në fushatën e zgjedhjeve të qershorit kryeministri i kërkoi policisë të flakë uniformën dhe të bënte vota për Partinë Socialiste. Ambasadorët e huaj që s'lënë gjë pa komentuar nuk folën" - tha z.Vasili.

pranuar po ai vetë publikisht dhe ka bërë dhe sikur ka kërkuar falje. Prokuroria s'ka asnjë të drejtë të heshtë më, ose ka zgjedhur të jetë ajo shkelësja e madhe e ligjit",- u shpreh z.Vasili.

Franca: S'duhet të nxitohemi për hapjen e negociatave me Shqipërinë

**Anëtarësimi në BE, Vasak: Mos shkoni më shpejt se muzika**

*"Kushtetuta përcakton kohëzgjatjen e një mandati"*

Valentina Madani

Franca një nga vendet anëtare të BE-së i kujton Tiranës zyrtare zbatimin e reformës në drejtësi si një ndër kushtet e hapjes së negociatave për anëtarësim të Shqipërisë në familjen evropiane. Ambasadorja franceze në Tiranë, Christine Vasak i ka prerë hovin qeverisë shqiptare për hapjen e negociatave me Bashkimin Evropian. Nga Korça ambasadorja franceze Christine Vasak preferoi të kujtojë shqiptarëve një shprehje franceze. "Mos shkoni më shpejt se muzika", tha ajo, duke nënkuptuar që Shqipëria nuk duhet të nxitohet për sa i përket çështjes së anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Diplomata franceze theksoi se nuk duhet të nxitohet, pasi do të priten rezultatet e raporteve, ndërsa kryefjala do të jetë zbatimin e reformës në drejtësi. "Është një vlerësim që duhet të bëhet nga të gjithë shtetet anëtare të BE, ne presim shumë raporte, Mos shkoni më shpejt se muzika", është një shprehje franceze. Është një dëshirë e



Ambasadorja franceze në Tiranë, Christine Vasak

madhe e popullit që të bëhet pjesë e Bashkimit Evropian, Shqipëria është kandidatë nga viti 2014, tani ka ardhur momenti të presim vendimin e institucioneve dhe autoriteteve evropiane për hapjen e negociatave, por nuk duhet të nxitohemi. Kjo analizë do të bëhet duke u bazuar në sistemin e drejtësisë në Shqipëri"-deklaroi Christine Vasak. Ambasadorja komentoj situatën e Kryeprokurorit në Shqipëri duke deklaruar se Kushtetu-

ta shqiptare e përcakton qartë kohëzgjatjen, duke lënë të nënkuptuar se mandati i Llalës ka përfunduar, sipas dokumentit të EURALIUS dhe OPDAT, të publikuar pak ditë më parë në media. "Kushtetuta shqiptare përcakton kohëzgjatjen e një mandati. Mandati i Kryeprokurorit të Përgjithshëm përfundon sipas Kushtetutës dhe autoritetet kompetente janë ato që duhet të vendosin" theksoi ambasadorja e Francës në Shqipëri.

**Taulant Balla: Mbështetje reformës zgjedhore**

Në përmbyllje të vizitës zyrtare në SHBA sekretari i Përgjithshëm i Partisë Socialiste, z. Taulant Balla takoi përfaqësuesit më të lartë të Institutit Demokratik Amerikan ku u diskutua për bashkëpunimin ndërmjet Partisë Socialiste dhe Institutit Demokratik Amerikan (NDI). Balla u shpreh se konkretizimi i këtij memorandumi bashkëpunimi është tepër i vyer për zhvillimin e transparencës së financimit të partive politike në vend, duke qenë se kjo e fundit është një prej çështjeve më të rëndësishme që po diskutohet sot në politikën shqiptare. Një fakt tjetër i rëndësishëm është se NDI është i gatshëm të mbështesë dhe të asistojë komisionin e reformës zgjedhore. "Do doja të theksoja që NDI është i gatshëm të mbështesë dhe të asistojë komisionin e reformës zgjedhore",- tha z.Balla.

**Drejtësia, Bushati: Garanton mbrojtjen e të drejtave e lirive**

Për ministrin Ditmir Bushati 10 Dhjetori, Dita Ndërko mbëtare e të Drejtave të Njeriut, përbën një moment të veçantë në kalendarin tonë. "Sfidat e ndryshme, së pari ato në fushën e sigurisë, vështirësitë ekonomike apo ritmet e zhvillimeve ndërkombëtare vazhdojnë të venë në sprovë shkallën e mbrojtjes dhe respektimitin e të drejtave themelore të njeriut. Çmimi që shoqëritë kanë paguar dhe përpjekjet e mëdha për liri dhe demokraci nuk duhet të lejojnë asnjë erozion të të drejtave të individit. Historia ka treguar se kudo, paqja, stabiliteti dhe prosperiteti ekonomik garantohen realisht vetëm nga demokracia, sundimi i ligjit dhe respektimi i plotë i të drejtave të njeriut. Pikërisht këtë synojmë të arrijmë edhe në Shqipëri: zbatimin e reformës së thellë në drejtësi do të garantojë një shkallë më të lartë të zbatimit të shtetit ligjor, por edhe të mbrojtjes së të drejtave e lirive në vend",- tha z.Bushati. Po ashtu, shtoi ai, miratimi së fundmi nga Kuvendi i Shqipërisë i ligjit për të drejtat e pakicave kombëtare përbën një nga instrumentet më të avancuar në këtë fushë në hapësirën europiane. "Këtë vit Shqipëria mbylli me sukses mandatin e saj të parë si anëtare e Këshillit të të Drejtave të Njeriut të OKB-së, gjatë të cilit kontribuoi, së bashku me vendet partnere për të nxitur e mbrojtur të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në botë. Shqipëria do të mbetet e përkushtuar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, duke përmirësuar instrumentet që garantojnë të drejtat dhe liritë shoqërore e individuale",- theksoi ministri Bushati.

**Drejtësia dhe vetingu, Ruçi informon kongresmenët amerikanë**

Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi, mori pjesë në forumin parlamentar për inteligjencën dhe sigurinë në Washington D.C. ku shoqërohej në forum nga Taulant Balla, Mimi Kodheli, Anastas Angjeli dhe Fatmir Mediu. Kryetari i Kuvendit i informoi kongresmenët dhe senatorin për ecurinë e deritanishme të implementimit të reformës në drejtësi dhe mbi procesin e vetingut. Në takim me kongresmenët amerikanë Ruçi tha: Hejja e tatimit të dyfishtë Shqipëri-SHBA, incentive që do t'i bënte kompanitë amerikane më të interesuara për investime në Shqipëri. Sipas njoftimit për shtyp, Ruçi falënderoi Kongresin Amerikan për vëmendjen ndaj rajonit dhe kërkoi prezencë më të lartë të kompanive amerikane në Shqipëri. Gramoz Ruçi shoqërohej në forum nga kryetari i Grupit të PS, Taulant Balla, si edhe nga Mimi Kodheli, Anastas Angjeli dhe Fatmir Mediu.

# THEMELIMI I PD

## INTERVISTA

Ish-themeluesja e PD: Dreka me Berishën dhe shqetësimi i tij një ditë pas rrëzimit të bustit

# Debatet në '91, Natasha Lako: Pse propozova Dritëroin kryetar Kuvendi

## "Të nesërmen njerëzit më uronin në rrugë"

Valentina Madani

**P**raardhësit e saj, Natasha Lakos i lanë trashëgimi dijen, kurse ajo mendoi për diçka edhe më të madhe, që fëmijët e saj e bashkëmohatarët e tyre në të gjithë Shqipërinë një ditë të mund të jetonin të lirë. Ndaj guxoi 27 vite më parë. Atë çfarë përjetoi gjatë periudhës së vështirë të rrëzimit të diktaturës, ku jeta ishte një hap larg vdekjes, Natasha Lako e rrëfen për herë të parë për "Gazeta Shqiptare" sikurse flet për përfshirjen në krijimin e PD-së, angazhimin dy mandate radhazi në Kuvend, debatet që e shoqëruan PD në momente kyçe të historisë së saj deri në largimin nga politika. Natasha Lako është shkrimtare, skenariste e një sërë filmash shqiptarë, publiciste. Ajo është përfshirë në antologji botërore të poezisë dhe në disa përmbledhje ndërkombëtare poetike. Por Natasha Lako është ndër të parat intelektuale në vend që iu bashkua që në fillim Lëvizjes për demokraci në dhjetor '90, është bashkëthemeluese e PD-së dhe dy herë deputete e saj në parlamentin e parë pluralist.

**Zonja Lako a jeni e ftuar sot në pritjen e organizuar nga z.Basha për 27 vjetorin e themelimit të PD-së?**

Jo nuk jam e ftuar.  
**I dini arsytet?**

Jo nuk i di dhe nuk dua të bëj asnjë koment lidhur me këtë çështje.

**Cila ishte jeta juaj në vitet e komunizmit.**

Te në flitet shumë pak për brezin e lindur pas Luftës së Dytë Botërore, sepse vëmendja gjithnjë shkon te ata që krijuan një sistem, për të cilin asnjë herë nuk u rrëfyer deri në fund, siç bën çdo njeri kur ikën nga kjo botë. Dhe sot duhet të rremësh nëpër arkivat angleze, ose në kujtimet e Esesëve, që të kuptosh vendin tënd. Shumë gjëra nuk u thanë kurrë dhe tani secili nga ne thotë Eureka, sa herë zbulon diçka. Jeta ime nuk mund të ketë zbulime kaq pikante, përveçse ca copëzave të krijimtarisë sime, pa asnjë lidhje me gladiatorët e sotëm.

Ajo është si e gjithë shqiptarëve të tjerë, me të njëjtin sistem të gjetur arsimit, të njëjtat tema hartimi, me të njëjtat autokritika të stileve të ngjashme, me të njëjtin kërcënim nga sindroma e Stokholm in që trinte prapa dere.

Nga ana tjetër, një vajzë e vetme e një familje korçare, me njërin gjysh të emigruar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, i cili që në vitin 1908 me ato gjysmë letrat e tij, kishte krijuar ndoshta alfabetin e tij me shkronja spontane të anglishtes. Dhe me tjetrin gjyshin beratas, i cili prej vitit 1914 deri në vitin 1917 la të shkruar një ditar shumë personal që sot gjendet në Arkivin e Shtetit. Dhe këtë e them, se baballarët tanë nuk patën mundësi të linin pas ndonjë trashëgimi ekonomike, sa të gjithë flasin më tepër për gjyshërit e tyre. Por kjo nuk do të thotë që për kohën të mos kisha një pagë të mirë. Shtoj këtu se jam një nga shqiptarët e pakët që kam parë



Ish-themeluesja e PD-së, Natasha Lako

shumë para rrëzimit, murin e Berlinit, tronditës edhe kjo.  
Mos prisni të komentoj edhe më tej jetën tonë brenda një miniatyre të çuditshme të një pushteti jashtëzakonisht të përgjendur, një bisht pushteti orientali evropian që ka pasur karakteristikë mijëra vjeçare zhvillimin e sistemit ujqor, që ne e kemi parë me sytë tanë, vetëm në mes të shekullit të XX. Por kjo nuk na pengonte të këndonim: 'Sa i gjerë dhe sa i gjatë ky kanali i Myzeqesë...'. Dhe kjo sigurisht nuk do të më kujtohej pa përmbytjet e kohëve të fundit dhe pa u menduar gjatë se përse sistemi ynë ujqor u shkatërrua. Ngandongjehere nuk e di se je si ajo që të vështrojnë dhe të gjykojnë të tjerët.

Por meqenëse detajet janë ngandongjehere më të rëndësishëm nga vetë dëshmitarët, mund të më përfytyroni, para ca ngjarjeve të tjera të mëdha, sapo të kthyer nga Greqia, me një kovë plastike pastrimi nëpër një tren çalë-çalë për ta cuar si model në fabrikën e plastikës në Durrës, në mbrojtje jo të drejtave, të përgjithshme të grave, por vetëm të duarve të tyre. Besoj se ndonjë grua e asaj fabrike plastike e mban mend dhe e ka kuptuar se aleanca ime me jetën e çdo gruaje shqiptare ka qenë gjithnjë e para. Dhe kuptohet gëzimi im, kur pas rrëzimit të murit të Berlinit dhe pas vizitës së Perez De Kuelarit, të rrezohej i pari në Shqipëri dënimi me vdekje për gratë.

**Si ju gjeti viti '90 dhe sa e vështirë ishte kundërvënja ndaj një regjimi diktatorial që kishte qeverisur shqiptarët për 50 vite me radhë?**

Me një mike të mirë si Eglantina Mandija, shkrimtare, nga e cila kisha dëgjuar çfarë

është kufiri i çuditshëm në jetën e gruas, ishte kapërcimi në vitet 40. Ndoshta se rriten fëmijët. Me shfaqjen në maj të '90 të filmit "Fletë të bardha" që flet për krizën e jetës krijuese dhe familjare të një shkrimtari të stanjacionit shqiptar dhe që na dha me tepër se sadsifikacion shqetësime të mëdha. Por na bëri të kuptojmë nga njerëzit që na merrnin në telefon se Shqipëria po ndahej hapur në dy krahe. Me një letër dërguar Ramiz Alisë pas kërcënimeve të botuara publikisht, si atakues të sistemit dhe statuskuosë së vendosur dhe menjëherë si shpëtimtare për në ngjarjet e dy korrikut, ndarjen tjetër të madhe të shpallur me njerëzve që mbanin në këmbë ende pushtetin dhe njerëzve që

kërkonin të largoheshin si në një formë braktisjeje dhe shpëtimi prej tij, me ca shqiptarë menjehollë, të cilëve u kishte rënë ndërmend të shisnin në treg hapur, që të mos i zinte policia me shkëlma krahas tufave të majdanozit dhe të koprës, portretin e Enver Hoxhës, Anshajnimit dhe Jezu Krishtit.

Në këtë vorbull të ngatërruar më bie ndër mend shpesh se një ditë pas deklaratës së Kadarese që kishte lënë Shqipërinë, shkova në shtypshkronjën që quhej "8 Nëntori" të marr pesë kopjet e vëllimit tim poetik i Natyrës e qetë të cilin e dua shumë. Portieri nuk po më linte të hyja, ndoshta nga ndonjë urdhër i drejtorit që po dilte rastësisht, dhe unë pata rastin të dëgjoj mallkime për të gjithë shkrimtarët.

**Për çfarë "mallkimesh" bëhet fjalë...?**

Po, po, dëgjova atë frazën e shkruajtur po prej Kadarese; A këta shkrimtarët!... Sepse nuk po flasim për stereotipin e krijuar tashmë të intelektualit që i afrohet vetëm atij që

### PËR DRITËRO AGOLLIN

"Kur e propozova Dritëroin, thjeshtë mu duk një rrugëzgjidhe e arsyeshme, mes gjithë atyre debateve të stërzgjatura dhe të pakuptimta. Për të vendosur apo për të mos vendosur si kryetar partie një njeri që studentët nuk e donin. Mbaj mend se si u kthye të më shihte Berisha. Kjo është dita ndoshta që po më shihte për herë të parë vërtet", - rrëfen znj.Lako.



Kuvendi Popullor në vitin 1991

fiton, por për ditë të turbullta fare, kur nuk dihej se si do të shkonin punët. Atë ditë në oborrin e shtëpisë botuese është bërë një miniprotestë e vërtetë e grave që ndoqën debatin mes meje dhe zyrtarit. Por kjo nuk kishte fare rëndësi përpara përzemërsisë së çuditshme që treguan punëtoret e shtypshkronjës. Këto gra të vitit '90, më hapën portën a deriçkën, më dhanë pesë kopjet e librit me një vështrim gati të lumtur ngaqë kisha kundërshtuar fort udhëheqësin e tyre të vogël dhe të gjitha më ofruan nga buka që kishin marrë me vete. Po fillonte një kohë e re e historisë moderne, në kushtet e buzëve të thara. Dhe mendoj se këto hapa të parat për ndryshim në Shqipëri i kanë bërë gratë.

Kam qenë e pranishme në një mbledhje, kur filluan të ankoheshin për herë të parë me zë të lartë se nuk kishte në dyqane as tenxhere. Madje edhe kam shkruar se si bërtisnin se nuk gjenin më tiganë sa dukej se po paralajmërohej edhe fundi i skuqjes së pataveve.

**Në çfarë viti bëhet fjalë për këtë protestë që përmendi ju?**

Bëhet fjalë në vitin 1988. Ka qenë një mbledhje e bashkimit të grave që zhvillohej këtu në Tiranë.

**Sa ndikoi takimi i 12 gushtit '90 i intelektualëve të kryeqytetit me ish-presidentin komunist Ramiz Alia në ndezjen e shkëndijave të para të demokracisë shqiptare? Si pasqyruan ndryshimin e sollën intelektualët apo studentët?**

Nuk mendoj se kjo mbledhje me intelektualë ka ndonjë peshe të madhe, sepse i ngjante thjeshtë një mbledhjeje të hapur partie. Madje nuk mund t'i tejkalonte dot ngjarjet e 2 korrikut me vrull të shumta që nuk përmenden asnjëherë me hollësi dhe nuk mund të shërbente si shkëndijë për lëvizjen e dhjetorit. Ka gjithnjë njëfarë kafonomie me shumë lloj ndikime nga lart. Sepse në vështrimin ngjarjet të derdhura nga lart, por që nuk gjenin asgjë në fillim të materies së kapitalizmit, gjë që sigurisht vazhdon të shkaktojë shumicën e problemeve shqiptare. Lëvizja e studentëve, ishte shumë më përpara se ajo e qëndrimit të intelektualëve shqiptarë. Të rinjtë sigurisht kishin nevojë për të pasur rreth e rrotull disa njerëz me prestigj publik. Por edhe kjo aleancë do të ishte tepër e shkurtër, sepse përvoja gjithmonë të mposht.

**Bashkë me bashkëshortin tuaj, regjisorin e njohur Mevlan Shanaj ju bashkuat lëvizjes studentore dhe themelimit të PD-së, por çfarë ju shtoi familjarisht që të ishit pjesë e partisë së parë pluraliste në vend dhe çfarë rreziku ju kanosej ju në atë kohë?**

Drejt lëvizjes studentore sigurisht që në radhë të parë më çoi krijimtaria ime që pas trysnive të rënda të mesit të viteve '70, po çlirohej pak nga pak. Vetë skenari "Fletë të bardha" me qendër një shkrimtar, ndryshe nga kërkesat për veprim që të imponon gjuha e filmit, kur e shkruajta kufizonte



← çdo lloj hapësire të veprimit kur në realitet, nuk linin të përdorje buzë liqeni një kamerare dhe jo më një barkë. Pjekuria artistike kërkonte shumë. Por sigurisht ndikuan dhe lidhjet me studentët që i kisha parë të rebeluar si anëtarët e rrethit letrar, me të cilët u lidha më fort kur punoja në Lidhjen e Shkrimtarëve për talentet e reja. Ishim, gjithashtu, në familje dy, në një gjendje të demokratizuar" të ngjashëm me pushtetin legjislativ dhe ekzekutiv, që kishim krijimtari të përbashkët dhe kjo sa na ndihmonte, aq do të na çonte edhe drejt provokimeve dyfish. Pastaj rrahjet e studentëve. Pavarësisht nga të gjitha këto, si shkaqe në radhë të parë për të shpëtuar veten, unë as mund të mendoja ndonjë jetë partie.

Por kur bashkëshorti im u bë një nga nismëtarët e krijimit të PD-së, dhe hodhi firmën pa u konsultuar me mua siç kishin bërë të tjerë më bashkëshortet e tyre dhe ishte vendosur, kuptova edhe një herë se sa i papëlqyer ishtë për me centralizimi i fortë familjar, i thënë ndryshe patriarkalizmi si një puro e fortë. Dhe njerëz që kërkojnë edhe në familje të ndarje të pushteteve burrë e grua, sigurisht do të vrapojnë të parët drejt të drejtave të tyre të tjera.

Pra edhe për çështje më logjike për të rezultuar karshi trysnie, ishin të rrallë ata që hidheshin dyfish këmbë dhe kokë në peripeci të paparashikueshme dhe nga më të vështirat, aq sa për brezat e rinj duken si të babesueshme. Ka njerëz që i kanë pasion arkivat dhe mund të zbulojnë edhe prapaskanat politike, madje edhe trysnitë e gjithanshme dhe intrigat që edhe atë kohë sikur rishfaqen në një cikël tjetër kohën kur gjithë im mbante ditar, që përkonte me luftën e parë tragjike botërore, e cila konfigurimi edhe jetën e ardhshme shqiptare.

Por nuk e prisja edhe nga presionet dhe kërcënimet me telefon, me një intensitet që arriti kulmin do t'i dëgjoja pasi botova një shkrimi ku dënoja vendimin e Gorbaçovit për hyrjen e tankeve ruse në vendet e Baltikut ende pjesë e BRSS.

Dhe vetëkuptohet se çdo të thotë kjo. Dëgjoi sot komente dhe analiza të shumta për këtë periudhë. Flitet shumë për njerëzit e 'paresyve të bardha', madje ka edhe një titull libri. E harrojnë madje edhe xhupin e Azemit. Paresyja e bardhë, është shenjë e modës që arrinte te intelektualët shqiptarë nga dyqanet e lira. Edhe unë e kam sjellë nga Parisi për Mevlanin dhe me qeshet kur kujtoj konotacionet që i japin sot. Dhe në qoftë se flasim për shkaqet që çuan disa intelektualë drejt lëvizjes demokratike, janë edhe traumat dhe përbitimet që kanë bërë ata kur kanë rënë në hapësira të lirisë. Dhe këtë sigurisht e kuptojnë gjithë ata që vazhdojnë edhe sot të dalin jashtë kufijve shqiptarë.

**Si lindi propozimi i emrit tuaj për deputet në vitin 1991? Kush ua bëri propozimin dhe a kishte dilema për ju në atë mo-**

Ish-deputetja: Kur kandidova në Korçë, dikush tentoi të më fshinte karrigen

# Lako: Flasin për 'paresytë e bardha' dhe harrojnë xhupin e Azemit

"Gratë protestuan në '88-ën, më pas studentët"

**ment?**

Mendon i qoftë një tryezë ku rreth e rrotull janë ulur vetëm burra, siç ndodh sot në qendrat e lojërave të fatit. Kështu do të ishte edhe parlamenti i parë dhe opozita e parë, po të mos kishte fare fytyra femrash, këto Kasandrave kaq të ndjeshme, që rrethanat dhe tradita më pas në mënyrë të pa parashikueshme do t'i tërhojë prapa, veçanërisht në elektoratin e PD-së.

Ndoshta korçarët nuk do të më kishin propozuar për deputete të tyre, sikur të mos kisha marrë pjesë në mitingun e parë, të 30 dhjetorit të vitit '90. Ishte një tentativë push-teti si të thuash paralel vajta ime në Korçë, sepse nuk shkova me njerëzit kryesorë të Partisë, madje as më shkoi mënjanda të qëndroja pranë tyre, pasi kisha lidhjen time të pacenueshme me vendlindjen time. Gjë që mesa duket më bëri edhe përfaqësues të tyre në Kuvend dy herë me radhë. Nuk mund të them se ç'ndodhi atë natë në familjet korçare që e kishin ruajtur lirinë brenda vetes. Nuk fjeta në hotel po në një shtëpi, ku më dhanë për darkë një pjatë me lakër turshi, që edhe tani e quaj të mrekullueshme, sepse kisha kohë që u blija fëmijëve për mëngjes petulla se nuk kishim kohë të blinin bukë atje ku shtyeshin të gjithë. U ktheva vetë në Tiranë me autobus dhe me lanë vendin e faktorinos, që ishte gjithnjë më i privilegjuari. Mbj mend se një burrë u sul të fshinte me shaminë e tij sediljen ku do të uletsha.

**Kur ndodhte një gjë e tillë?**

Kjo ndodhte në 31 dhjetor, kur 100 e grave shqiptare, ose pa mua 100% - 1, shtroron tryezën e vitit të ri, festën më të bukur që kanë shqiptarët. E dashur vajzë, ti nuk do të gjesh më dhe asnjëherë si në dhjetor të vitit 1990, gjithë ato fytyra të bukura të Tiranës atëherë as me 200000 banorë.

**Disa prej tyre u vranë. Si e keni njohur Azem Hajdarin?**

Vetëm disa ditë më pas u gjend me Azemin që nga afër nuk e kisha parë, në një reparat te tezgjahut të kominatit të atëherëshëm të tekstilist ndoshta ende me emrin Stalin. Ishte ftohtë se mbaj mend pallton time që e ruaja plot kujdes. -Ja e shihni ketë zonjë, tha atëherë duke treguar nga unë Azem Hajdari. Ju siguroj se keni për të jetuar si kjo, më mirë se kjo. Dhe shpresoj që vërtet të jetë realizuar profesia e Azemit dhe ndonjëra prej tyre të jetë sot nëna e ndonjë biznesmeni plot suksese, jo i suksesshëm ku të bezdis edhe përplasia e gërmeve.

**Po me z.Berisha? Cila ka qënë biseda e parë me të?**

Mund të ketë rëndësi dita kur e kam parë së fundi. E kam parë edhe të transformuar nga pushteti i madh që mbante në duart e tij. Por nuk dinte ta fshihte këtë përqendrim pushteti siç bën Edi Rama. E kam njohur Berishën nga pranë gjatë mbledhjeve të grupit parlamentar pas zgjedhjeve të para të pluralizimit. Për mua kanë mbetur të paharruara, pavarësisht se sot punohet me dashje apo pa dashje, nga teveqelëllëku apo nga qëllimet, që të rrezohet plotësisht për ditë çdo dinjitet i parlamentarizmit shqiptar.



Madje parlamentarizmi i viteve '20-'30 pothuaj nuk përmendet fare. Për mua Berisha fitoi një autoritet të mistershëm pasi u bë president.

Por e kam parë edhe jashtëzakonisht të shqetësuar kur erdhi një kohë dreke në shtëpinë tonë një ditë pas rrëzimit të monumentit të Enver Hoxhës, pa e ditur ende nëse do të vendosej apo jo gjendja e jashtëzakonshme.

**Përse kishte ardhur z.Berisha në shtëpinë tuaj?**

Donte të merrnim vesh diçka më tepër nga dy të njohurit tanë të afërt shkrimtarë ndoshta, anëtarë më të moderuar të asaj instance që po ndillte kob. Kurrë nuk do të harroj se si filluan t'i dridhjet tabakaja me filxhanë të kafesë në duar nënës sime. Dhe mendoni se sa histori të tjera ka, që nuk kanë aritur të hyjnë në një të vetme. Vetëm të rrih dhe të vështrosh kush hyn dhe kush del për njëzet e shtatë vjet me radhë, me faj e pa faj, me sukses apo pa sukses, në raste festash në pritjet presidenciale. Sot shumë njerëz, i komentojnë këto ngjarje, njësoj si të kishin parë një teatër; kush u përleq, çfarë nuk u përleq, si duhet të ishte si nuk duhet të ishte. Mos harrojmë se Tirana sot është bërë 100000-she! Dhe ndjehet tendenca për të lënë si një libër të bibliotekës këtë ngjarje jashtë trupit të jetës shqiptare dhe jashtë frymës së institucioneve, nga të katër anët. Madje edhe të zbatimet.

**Me 17 prill 91, Kuvendi duhej të zgjidhte kreun e ri të Kuvendit dhe diskutohet kandidatura e Islamit, ku Shane Korbeel, ish-ministër në qeverinë e fundit komuniste dhe ish-kryeministri i kësaj qeverie, Adil Çarçani, e mbronin Islamin, ju si deputete PD-së propozuat një tjetër emër nga Partia e Punës së Shqipërisë si kandidat më konsensual për kryetar i Kuvendit. Ishte shkrimtari Dritëro Agolli. Pse pikërisht ai gëzonte respektin e deputetëve të PD-së edhe pse ishte në partinë kundërshtarë?**

Po, mirë, le t'i kthehem përsëri pak intelektualëve në një vend ku dihet që po ndodh proces i zakonshëm i shkatërrimit të intelektualizmit shqiptar, njësoj si shkatërrimi i

**PROTESTA**

"Kam qenë e pranishme në një mbledhje, kur filluan të ankoheshin për herë të parë me zë të lartë se nuk kishte në dyqane as tenxhere. Madje edhe kam shkruar se si bërtisin se nuk gjenin më tiganë sa dukej se po paralajmërohej edhe fundi i skuqjes së patateve", -thotë znj.Lako.

kanaleve kulluese. Dritëro Agolli, ishte një navigator i madh mes përmes forcave të pushtetit, në sajë të mprehtësisë praktikitetit dhe talentit të përgjithshëm. Më qetësonë prania e tij, ajo koka e tij në formë dardhe me ato flokë të bardhë, sa herë e shihja nga prapa, mes fanatikëve, të cilët më vonë do t'i mësonin edhe deputetët e PD-së që sa të merrnin mandatin të rrëmbejnë edhe një kobure. Kur e propozova, thjeshtë mu duk një rrugëzgjidhje e arsyeshme, mes gjithë atyre debateve të stërzgjatura dhe të pakuptimta. Për të vendosur apo për të mos vendosur si kryetar partie një njeri që studentët nuk e donin. Mbj mend se si u ktheje të më shihte Sali Berisha. Kjo është dita ndoshta që po më shihte për herë të parë vërtet.

**Megjithatë ju e bëte propozimin...?**

Po, por propozimi im ç'tensionoi të gjithë Tiranën. Mbj mend se më ndalnin dhe më përqafonin në rrugë shumë njerëz. Atëherë kuptova se në politikë askujt nuk i nevojiten fjalët e acarta që deri sot përdoren gabimisht çdo ditë, duke ndjellë humbjen e shqiptarëve në përgjithësi. Por kjo kërkon një eksperiencë të madhe.

**Është folur atëherë se z.Agolli ka votuar Berishën president. Si është e vërteta?**

Nuk besoj se Dritëro Agolli ka votuar për Sali Berishën president, herën e parë, megjithëse ky lajm orientoj gjithë grupin parlamentar dhe shkaktoi gati edhe survejime.

Ishte dhe madje deri sot është e vështirë të mësojnë politikën, njerëz që për një kohë të gjatë kanë kënduar njësoj të njëjtën këngë me fjalët "Enver Hoxha mprehu shtatën dhe njëherë për situatën"...dhe që mësojnë për herë të parë fjalën konsensus, që në fillim ishte e pabesueshme. Dhe është vështirë të mësoh gjithën e politikës që di të bëjë kur duhet kompromise dhe di kur duhet të jetë i prerë. Historia e kësaj periudhë tranzicioni është një përvojë që mëson se plaga shërohet nga brenda, dhe nga kjo përvojë mund të përfitohet gjithnjë. Sepse nesër, pasnesër edhe Koreja e Veriut, me siguri do të pësojë transformim e vet ose do të ketë kohën e saj të tranzicionit, domethënë të shkrumit të saj, por me një ndryshim të madh: në qoftë se Koreja e veriut prodhon armë atomike, shqiptarët ishin mbretër të kallashnikoveve që sot janë shpërndarë në të gjithë botën.

**Pse u larguat nga politika...?**

Nga politika nuk mund të largohet njeri. Kjo është e pamundur, edhe kur gënjëjmë veten. Unë thjesht dhashë dorëheqjen. Vetë dorëheqja ime për atë periudhë ishte akt politik, që u mjegullua nga të katër anët.

Sistemi elektronik i lejeve të ndërtimi, procedura e aplikimit

# Procedurat e reja për pajisjen me leje për punime në shtëpi

*Punime të brendshme, njoftim me shkrim*

Ornela Manjani

**C**do subjekt, i cili kërkon të pajiset me leje apo të paraqesë deklaratë paraprake për kryerje punimesh, është i detyruar të dorëzojë aplikimin për leje dhe dokumentacionin shoqëruar nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve. Vendimi është marrë dje në mbledhjen e Këshillit të ministrave ku për kryerjen e punimeve të brendshme, si: përfundimi i strukturave mbajtëse të brendshme, hapja dhe mbyllja e detyrës të brendshme; krijimi, eliminimi ose ndryshimi i mureve ndarës (jombajtës) të brendshëm, i mjediseve për shërbime higjienike dhe realizimi i impianteve të reja higjieno-sanitare dhe të ngrohjes/ftohjes duhet të njoftohet sistemi elektronik i lejeve. Ndryshimet e fundit ligjore parashikojnë që çdo person që kryen punime për ndërrhyrje të jashtme për riparim dhe zëvendësimin e rifiniturave të jashtme të ndërtesave, me kusht që të ruhen karakteristikat origjinale të tyre, si: rifreskimi i llyerjes, suvatimit dhe veshjes së fasadave me materiale që kanë karakteristika dhe ngjyra të njëjta me ato ekzistuese; pastrimi i fasadave; riparimi dhe zëvendësimi i dritareve dhe detyrës, qepenave dhe vitrinave (duke përfshirë përdorimin



Foto ilustruese

e materialeve të ndryshme), pa ndryshuar karakteristikat e tilla si forma, ngjyra nuk duhet të pajiset me leje ndërtimi, por duhet të njoftojë para se të nisë punën.

## DOKUMENTET

Dokumentet që duhet të depozitohet personi i interesuar për njoftimin e deklaratës paraprake për kryerje punimesh, janë: Formulari i deklaratës, sipas kësaj rregulloreje dhe formatit të përcaktuar në sistemin elektronik të lejeve, dhe, sipas rastit: Dokumenti që vërteton pronësinë e tij apo të drejta të ligjshme për pa-

suri private ose publike, për strukturën që ka në përdorim, në përputhje me legjislacionin në fuqi; Projekti teknik i realizimit të punimeve, i firmosur nga projektues të licencuar. Brenda 5 ditëve nga dorëzimi i deklaratës paraprake për kryerje punimesh, nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, autoriteti vendor përgjegjës kryen verifikimet e nevojshme dhe, në rast se konstaton mosrrespektimin e kushteve dhe kërkesave ligjore që rregullojnë deklaratën paraprake të punimeve, e

kundërshton atë me vendim të arsyetuar. Në mungesë përgjigjeje nga autoriteti vendor përgjegjës, brenda afatit 5-ditor, konfirmimi konsiderohet i dhënë në heshtje dhe sistemi gjenon aktin përkatës e njofton deklaruesin për mundësinë e fillimit të punimeve.

## SISTEMI ELEKTRONIK I LEJEVE

Sistemi i lejeve shërben si pika e vetme, ku paraqitet, elektronikisht, kërkesa për leje, sipas legjislacionit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe realizohet procesi i bashkërendimit ndërinstucional, gjatë procedurës së shqyrtimit të kërkesave. Nga ky sistem realizohet monitorimi i lejeve të ndërtimit, të lëshuara nga organet përgjegjëse të qeverisjes vendore dhe nga Këshilli Kombëtar i Territorit;

## SHQYRTIMI I KËRKESAVE

Autoriteti vendor përgjegjës dhe sekretariati i KKT-së, sipas fushës përkatëse të kompetencës shqyrtojnë kërkesën për leje zhvillimi, duke bashkërenduar punën, nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, me të gjitha autoritetet publike të specializuara, nëse pasuria për të cilën kërkohet leja e zhvillimit ndodhet në zona apo është objekt me kufizime apo kushtëzime të veçanta sektoriale, për shkak të vlerave monumentale, arkeologjike, natyrore apo mjedisore.

## NJOFTIMI PËR NDËRRHYRJET

1. Rifreskimi i llyerjes, suvatimit dhe veshjes së fasadave me materiale që kanë karakteristika dhe ngjyra të njëjta me ato ekzistuese;
2. Pastrimi i fasadave;
3. Riparimi dhe zëvendësimi i dritareve dhe detyrës, qepenave dhe vitrinave (duke përfshirë përdorimin e materialeve të ndryshme), pa ndryshuar karakteristikat e tilla si, forma, ngjyra, dizajni dhe dimensionet e pjesëve të hapura dhe transparente;
4. Zëvendësimi i pjesshëm i mbulesës së çatisë, pa ndonjë ndryshim të formës, pjerrësisë dhe karakteristikave të veshjes;
5. Riparimi dhe zëvendësimi i ulluqeve e oxhakëve, edhe me materiale të ndryshme;
6. Riparimi i ballkoneve, tarracave dhe basamakëve apo barrierave mbrojtëse;
7. Vendosja e hekurave mbrojtës në dritare;
8. Vendosja e tendave të diellit dhe rrjetave kundër mushkonjave;
9. Sistemimi i oborreve;
10. Riparimi i rrethimeve ekzistuese.

## LEJA E ZHVILLIMIT

1. Dokumenti i lejes së zhvillimit i paraprin lëshimit të lejes së ndërtimit për ndërtim të reja, nga autoritetet vendore, dhe përmban, në nivel njësie:
  - a. përdorimin e tokës dhe strukturat e lejueshme;
  - b. intensitetin e ndërtimit;
  - c. koeficientin e shfrytëzimit të tokës për ndërtim;
  - ç. lartësinë maksimale në metra;
  - d. distancat;
  - dh. gjelbërimin publik;
  - e. parkimin;
  - ë. fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese, që pasqyron edhe lidhjen me infrastrukturën në zonë;
  - f. informacion rreth kufizimeve apo kushtëzimeve të veçanta në pronën përkatëse.

## DOKUMENTACIONI PËR PAJISJEN ME LEJE ZHVILLIMI

1. Dokumentet e vetme që duhet të paraqesë pronari ose zhvilluesi për t'u pajisur me leje zhvillimi, janë, si më poshtë:
  - a) Kërkesa për leje, sipas formatit të aplikimit, të përcaktuar në këtë Rregullore dhe në sistemin elektronik të lejeve;
  - b) Dokument që vërteton të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në zhvillim dhe, nëse ka, kopje të marrëveshjes për pronën;
  - c) Mandatpagesa e tarifës së aplikimit.

## Afatet për ndërrhyrjen në banesë, lajmërimi duhet bërë 5 ditë para

# 11 llojet e ndërrhyrjeve nga jashtë e brenda që mund të bëni

## NDËRRHYRJET E BRENDSHME

Administratori i Njesisë Administrative Nr. 11, Gentian Arapi bën të ditur se ndërrhyrjet e jashtme: riparimi dhe rinovimi i dyshemeve; riparimi dhe restaurimi i suvasë, veshjeve dhe ngjyrave; riparimi dhe rinovimi i detyrës dhe dritareve, përfshirë vendosjen e xhamave të dyfishtë, kryhen pa leje ndërtimi, por pas dorëzimit në njësinë administrative të deklaratës së punimeve. Me të njëjtat kushte mund të kryhen edhe ndërrhyrje në impiante higjieno-sanitare: veprat e riparimit dhe zëvendësimit të pajisjeve higjieno-sanitare dhe riparimet e impiantit.

tur të gjithë punimet që mund të kryhen në shtëpi pa leje ndërtimi. "Kryhen pa pajisje me leje ndërtimi: a) Ndërrhyrje të mirëmbajtjes së zakonshme, që përfshijnë: i) ndërrhyrje të jashtme për

riparimin dhe zëvendësimin e rifiniturave të jashtme të ndërtesave, me kusht që të ruhen karakteristikat origjinale të tyre, si vijon: rifreskimi i llyerjes, suvatimit dhe veshjes së fasadave

me materiale që kanë karakteristika dhe ngjyra të njëjta me ato ekzistuese; - pastrimi i fasadave; - riparimi dhe zëvendësimi i dritareve dhe detyrës, qepenave dhe vitrinave (duke përfshirë për-



Foto ilustruese

dorimin e materialeve të ndryshme), pa ndryshuar karakteristikat e tilla si forma, ngjyra, dizajni dhe dimensionet e pjesëve të hapura dhe transparente; zëvendësimi i pjesshëm i mbulesës së çatisë, pa ndon-

jë ndryshim të formës, pjerrësisë dhe karakteristikave të veshjes; - riparimi dhe zëvendësimi i ulluqeve dhe oxhakëve, edhe me materiale të ndryshme; - riparimi i ballkoneve, tarracave dhe basamakëve apo barrierave mbrojtëse; - bën të ditur Arapi. Gjithashtu, punime që nuk mund të kryhen vetëm pas depozitimit në njësinë administrative përkatëse janë edhe vendosja e hekurave mbrojtës në dritare; vendosja e tendave të diellit dhe rrjetave kundër mushkonjave; lëvizja e shtrësive të sipërme të oborreve; riparimi i rrethimeve ekzistuese.

# VRASJA NE LEZHE CEREMONIALI MORTOR

Ekzekutimi i Aleksandër Ndokës, shoqërohen 20 persona në polici, ja pistat e hetimit

## I jepet lamtumira vëllait të ish-deputetit Ndoka

*I biri Samueli lë qelinë për varrimin e të atit, kushte të rrepta sigurie*

Mijëra njerëz u bashkuan dje për t'i dhënë lamtumirën këshilltarit bashkiak Aleksandër Ndoka, i cili u ekzekutua dy ditë më parë pranë banesës së tij, në lagjen "Nënë Tereza" të qytetit të Lezhës. Pjesë e ceremonialit mortor të vëllait të ish-deputetit të PS, Arben Ndoka ishin dhe emra të njohur të politikës. Në familjen Ndoka gjatë ceremonialit mortor kanë mbërritur dhe dy furgon të Policisë së Burgjeve, të cilët dërguan Samuel Ndokën, për t'i dhënë lamtumirën e fundit të atit. Samueli ka rënë në prangat e policisë dy muaj më parë. Familja Ndoka ka zgjedhur të heshtë përball asaj çfarë ndodhi ditën e shtunë, ndërsa Arben Ndoka falënderoi të gjithë ata që ju bashkuan dhimbjes së familjes së tij. Ndërkohë policia vazhdon hetimet për zbardhjen e ngjarjes dhe identifikimin e autorit. Mësohet se numri i personave të shoqëruar në policinë e Lezhës dy ditët e fundit, në lidhje me ekzekutimin e Aleksandër Ndokës, ka shkuar në 20. Ndërsa 8 personat e shoqëruar dy ditë më parë u lanë të lirë, 12 të tjerë janë shoqëruar këtë të diel.



Viktima, Aleksandër Ndoka



Djali i viktimit, Samueli i shoqëruar nga policia, gjatë ceremonialit mortor

### "Ky rrugëtim u pre shumë shpejt nga ligësitë"

#### I ekzekutuan vëllain, fjalët prekëse të ish-deputetit të PS

Ish-deputeti i Partisë Socialiste Arben Ndoka, pas ekzekutimit të vëllait ka reaguar me një status prekës në "Facebook". Aleksandër Ndoka u vra në orë e para të së shtunës pranë banesës së tij në Lezhë, ndërkohë që autorët janë ende të pidentifikuar. "Vëllai im i ndjerë, ka kaluar një jetë me sfida e vuajtje që në moshë të mitur 16 vjeç nisi punën të ferma e Torovicës, pastaj të fabrika e tullave, një punë e rëndë për moshën, por falë kurajës dhe forcës së tij nuk ndalej para asgjëje. Ishte njeri i dashur për të gjithë, i suksesshëm në karrierë dhe biznes, e aq shumë energji jepte për njerëzit ditë dhe natë. Gjatë gjithë rrugëtimit të jetës së tij më ka bërë krenar, sepse linte kudo respekt dhe kishte vlerat që i kanë hije një burri. Punoj me djersë dhe krijoi gjithçka me mund dhe sakrificë. Ky rrugëtim u pre shumë shpejt nga ligësitë që mbulojnë nga errësira e natës. La pas shumë njerëz që vajtojnë për të, sidomos familja e tij. Qofsh i parajsës vëllai im i dashur!", shkruan Arben Ndoka.



### DJALI I ALEKSANDËR NDOKËS

Samueli, djali i Aleksandër Ndokës, i ekzekutuar mbërrmen e së premtes me breshëri plumbash afër banesës së tij, mori pjesë në varrimin e të atit. Samuelit i është dhënë leje nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për të qenë dje në orën 13:00 afër familjes në një moment kaq të vështirë. I riu u shoqërua nën masa të rrepta sigurie dhe pas ceremonisë për varrosjen e të atit u rikthye sërish në qeli.

### Letra e Arben Ndokës për Grupin e PS, historia e vëllait të vradë dhe akuzat për prostitucion

Pas dorëzimit të man datit, në shtator të vitit 2015, Arben Ndoka, ish-deputeti i PS, i drejtoi një letër Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste. Në letër ai shkruante asokohe se ka marrë një dënim ta pamerituar nga gjykata italiane vetëm se futi në shtëpi të vëllanë bashkë me ish-të dashurën, e cila më pas e akuzoi për prostitucion. "Një ditë vëllai vjen në Itali dhe i telefonon një djali nga Lezha, i cili kish të makinë. I thotë që të shkonte ta merrte në Leçe, sepse kishte djegur këmbën gjatë udhëtimit me skaf dhe as në këmbë nuk rrinte dot. Erdhi tek unë me një vajzë me të cilën kishte një lidhje. Ata qëndronin te shtëpia, ku unë



Ish-deputeti i PS, Arben Ndoka

jetoja përafërsisht një javë dhe pastaj shkuan në Romë te një shok i vëllait. Nga ai moment humba dhe kontaktet me ta. Në atë kohë s'kishte telefoni si sot dhe në shqiptarët mblidheshim në një klub të dielave për t'i telefonuar familjeve. Më vonë

mësova që vajza ishte lidhur me një punonjës policie. Ai mbi bazën e një denoncimi të saj kishte sajuar një kontroll në shtëpinë e vëllait dhe në procesverbalin e kontrollit ishte shkruar që në shtëpinë e tij, u gjetën 1000 dollarë falsë dhe një peshore droge. Në fakt, ishte e sajura kjo gjë. Nga lidhja e vajzës me policin që u nda edhe nga gruaja për të bashkëjetuar me të, taksirati ynë s'pati fund. Më ndalojnë edhe mua, sepse sipas policisë duhet të jepja sqarime pse i kisha mbajtur ata të një javë në shtëpi. Kur doli vëllai në gjyq gjykatësi kërkoi provat materiale që, në fakt, nuk dolën askund, as peshore droge, as dollarë falsë", shkruhet në letrën e Arben Ndokës.

ksandër Ndoka ishte emëruar si kryeinspektor i IKMT-së për Veriun. Grupi i hetimit nuk përjashtoi dyshimin se ngjarja mund të ketë lidhje me detyrat e Ndokës. Por më e mundshmeja vlerësohet ndonjë konflikt i akumuluar

që në periudhën kur ai ka punuar në Hipotekë. Blutë nuk përjashtojnë as pista të tjera, që kanë të bëjnë me konflikte së fundmi të tij, por deri më tani nuk ka asnjë të dhënë konkrete për iniciativë hetimi në këtë drejtim. Kjo, pasi 48-

vjeçari rezultoi se nuk ka probleme me ligjin. Ai nuk ka precedentë dhe në formularin e dekriminalizimit rezultoi i pastër. Pista e dytë e hetimit lidhet me konfliktet që mund të kenë pasur djemtë e të ndjerit. Precedentët kriminalë

të dy djemve Klajdi e Samuel Ndoka mund të jenë shkak i atentatit ndaj tij. Dy djemtë njiheshin në Lezhë si mjaft problematikë dhe lëviznin të armatosur. Njëri prej tyre, Samueli, aktualisht është i arrestuar për ngjarjen e

ndodhur në ditën e zgjedhjeve ku ai plagosi një aktivist të LSI-së. Në momentin e arrestimit, atij iu sekuestrua edhe armë. Ndërsa djali tjetër, Klajdi Ndoka, është shpallur në kërkim nga policia për të njëjtën ngjarje.

## EKSKLUZIVE

"Sa e trishtueme jam sot. Tashti duhet të kesh arritë në Tiranë, do të jesh tue hangër dhe ndofta të shkon mendja edhe tek unë. Jam e mërzitun, në këtë çast doja të ishe me ty". Letra të ndjera dashurie të 53 viteve më parë.

# LETËRKËMBIMI I PANJOHUR I DASHURISË

## Dritëro Agolli: E dashur Sadije! Mjaft të jem në vetmi e jepem i tëri pas teje

Fatmira Nikolli

**T**ani që nuk të kam ty pranë nuk i vë rëndësi asgjëje: rri i parruar; i pahekurosor dhe me duar në xhepa. Kostumi s'ka ç'më duhet, e kam inat dhe nuk do ta qep- Dritëroi".

"Kam jetue një javë të tanë me gëzimin se do të vinja në Tiranë, se do të flenja një dhomë ku do t'na ndante vetëm një mur- Sadija".

Historia e letërsisë, njëhësisht botime që kanë përmbledhur letrat më të bukura të dashurisë të shkruara nga njerëz të penës për njerëzit e zemrës. Kujtojmë letërkëmbimin 15-vjeçar mes Albert Kamysë me të dashurën Maria Casares, letrat e Vita Sackville-West për Virginia Woolf, Oscar Eilde për Alred Douglas, Jean-Paul Sartre për Simone de Beauvoir, a Leo Tolstoy për Valeria Arsenov.

Frazat në hyrje të këtij shkrimi janë shkëputur nga libri ende në proces "Dashuri në moshën e Krishtit" - që përmbledh letrat që Dritëro e Sadije Agolli i kanë dërguar njëri-tjetrit në kohë që gjendeshin larg, shkruan "Gazeta Shqiptare". Për ditë me shi, për trishtimin e mbrëmjeve, për vetminë e muajve të gjatë, për mallin që shtohet nga largësia, për pallot që nuk i blinin, për tonet e fohta, për xhelozinë që dilte në pah, për jetën e pakuptimtë larg njëri-tjetrit, për netet që nuk shiheshin, për këshillat e dimrit, për premtimet e së ardhmes, për dashurinë për një grua; letrat janë jeta e dy viteve kur shkrimtari asokohe në moshën e Krishtit, 33 vjeç, i shkruante të dashurës së zemrës. Sot, pesë dekada më vonë, kanë një peshë tjetër. Ai nuk është më, ajo jeton me kujtimet e tij.

Shkrimtari u nda nga jeta në shkurt të këtij viti dhe ndërsa afron 1-vjetori i kësaj ikjeje, libri po merr formën përfundimtare. Letrat rrëfijnë mallin dhe ngjarjet e përditshme. Ai, i shkruante në toskërisht, ajo, i përgjigjej në gegërisht. "Unë kam ndërë se ti më do me tërë mënt", i thotë diku Dritëroi, duke vënë në dukje diku se një prej letrave iu duk e ftohtë e se megjithëkëtë, ai nuk do që letrat të jenë të shtritura, edhe me kushtin që mund të duken të ftohta.

Ka qenë Elona Agolli, që e ka nxitur këtë botim. Duket se ka ende kërkshërinë e fëmijës për të mësuar më tepër për të fshehtat e pashprehura të atit të saj. "Unike si korrespondencë, në vite e kohë që të surprizon", duke e krahasuar me letrat

"Dashuri në moshën e Krishtit", gati libri me letrat e shkrimtarit me të shoqen: Kur s'të kam pranë, asgjë nuk ka rëndësi



Në foto: Koptina e librit

mes Kamysë e Maria Casares, të botuara prej vajzës së tyre.

Libri, është nën kujdesin e Prof. Shaban Sinanit, i cili po punon me parathënien dhe një studim pasionant për atë që quhet "letërsi pasioni", zhanër i munguar në historinë e gjatë të letrave shqipe.

"Nuk m'u ndejt pa lexuar pak dhe u kënaqa shumë. Në këtë vend ku jemi, nuk është zakon letërkëmbimi i dashurisë. Prandaj them se të jetë një model edhe për të ndryshuar këtë perceptim që ekziston (edhe tek unë) për njeriun shqiptar. Unë pashë shumë gjëra të rëndësishme me aq sa shfletova, ka informacion për jetën krijuese të Dritëroit, ka situata etnokulturore,

ka gjendje mendimi, ka emocione, ka art fjale, ka finesë ndjenje", i shkruan ai Elona Agolli, të bijës së Dritëroit.

"Nga ky letërkëmbim, m'u zgjua kujtesa për një kohë që e kisha harruar, kishte mbetur në sirtaret e trurit, të fjetura vite dhe vite me radhë", -ka shënuar në pasthënies Sadija, bashkëshortja e shkrimtarit, duke shtuar "m'u zgjuan vitet e para të njohjes, të dashurisë mes të rinjve në botën e madhe në kohë kreu të ndryshme nga kjo e sotjima".

"Gazeta Shqiptare" ka mundur të marrë disa prej këtyre letrave, ndërsa Elona premtim surpriza të tjera.

### E dashur Sadije,

Nuk e di se ç'ka ndodhur me mua. Në moshën e Krishtit unë të bëhem kaq i papërmbytur në çfaqjen e ndjenjave të mija? Mjafton të qëndroj pakëz në vetmi e të jepem i tëri pas teje. Kurse kur jam me shokët nuk e kam mëndjen në muhabetin e përgjithshëm. Më thonë se paskam ndryshuar kaq shumë sa s'njihem. Unë nuk kam qejf të ndryshoj natyrën time,

prandaj ngushëlloj vehten, duke menduar se shokët, me që dijnë historinë time me ty, gabojnë në gjykimet e tyre. Po ç'është e vërteta unë ju jap të drejtë atyre se diçka ka ndodhur. Në mesditë të jetës dashuria qënka e çuditshme.

Dua që në këtë çast të jem me ty. Ti të rrish karshi meje, të flasësh, të qeshësh. E di ti se më pëlqen qeshja jote? Ti qesh fare, fare.

Shesh si është natyra e njeriut e dyfishtë? Unë në tregime e në vjersha jam shumë i përmbajtur, apo jo? Edhe në shkrimet e dashurisë bile jam i përmbajtur. Po kur nis të të shkruaj ty dhe e humb gjakftohtësinë. Adio, gjakftohtësi, armë e shkrimeve të mija! Pse vallë? Kjo siç duket është merita jote. Unë në përgjithësi kurrë nuk kam hapur sytë rrugëve pas fustaneve, po tani i kam mbyllur fare - kudo vetëm ty të shoh.

Letra është një shprehje e çastit. Sikur ne t'i shkruanim letrat e t'i mbanim pa i dërguar qoftë edhe një ditë, natyrisht po të ishim në gjendje shpirtërore normale, të tretën ditë do t'i grisnim e do të thoshim me vehte: ç'marrëzi kemi shkruar! Të tri letrat që të kam nisur para kësaj kanë plot marrëzira, se shpirtërisht nuk kam qenë mirë. Po mos u mërzi, njeriu duhet të ketë edhe çaste marrëzie, se do të na mbyste atëherë monotonia. Du-

E bija, Elona Agolli: Unike si korrespondencë, në vite e kohë që të surprizon

1964-1965/ "Le të besojmë se kjo është edhe koha më e bukur për të shkruar letra dashurie"




Në foto: Sadije dhe Dritëro Agolli

het të zbavitemi me ndonjë letër me nuanca anormale. Njerëzit zakonisht në këto letrat e dashurisë kanë qejf të bëhen ose hamletë, të tregojnë sa vuajnë e sa janë të mërzitun nga bota, ose të bëhen si xhaxhallarë të urtë me shprehje plot mirëzi e didaktikë, t'i mësojnë vazjat të mos bijen në gabime, t'u thonë atyre se ka njerëz që janë të liq e ku të di unë. Këta u shëmbëllojnë atyre njerëzve, të cilët kur flasin me femra i venë më shumë rëndësi intonacionit të zërit, gjesteve elegante, manierës së të qëndruarit dhe harrojnë të mjerët, natyrën e tyre. Fatkeqë! Me këtë, pa ditur edhe vetë, bëhen të mërzi të shëm.

Unë sot gjithnjë jam jetuar me ty. Shkonja në rrugë - isha me ty, shkonja në kafe - isha me ty, shkonja në bibliotekë të kërkonja ndonjë libër - isha me ty. Po ç'u bë kjo, thosha me vehte, ëngjill mbrojtës? Dreq o punë. Është mirë kur të duan, apo jo? Po jo kur të duan "se na bashkojnë zakonet dhe afërsitë krahinore".

Kur të duan krejt ndryshe, krejt pa përcaktuar, pa rregulla, atëherë mund të jesh e lumtur. Unë nuk kam qef të më duan me rregulla, nuk dua të hyj nëpër unazë si akrobat. Bile unë kam qejf këshu: nuk e ndjen vehten mirë me mua një ditë, thua: më mërzi, Dritëro, sot nuk të dua, nesër mund të të dua, m'u gduk tani nga sytë! Çaste të tilla ka, apo jo? Po njeriu është edhe rruftan-hipokrit, që ka frikë të hapet e të shprehë gjithnjë të vërtetën. Megjithëse ti këshu nuk më ke thënë asnjëherë, po unë ka patur raste, që çaste të tilla, të shkruara fatmirësisht, i kam nuhatur. E di që këto janë në natyrën e njeriut, prandaj as jam



Në foto: Sadije dhe Dritëro Agolli





# PAPUNESIA STUDIMI

Doktore e shkencave: Anomalitë në tregun e punës, vështirësitë që hasin të rinjtë

## Studimi, Rajmonda Kosiqi: 60% e punësimeve bëhen me "mik" "15% e të diplomuarve janë të papunë"



### SHIFRA JOREALE TË PAPUNËSISË

"Shifrat e publikuara nga INSTAT nuk paraqesin shkallën e papunësisë që ekziston vërtet në tregun e punës, pasi nuk bëhet evidentimi i të papunëve në të gjithë popullsinë. Vetë qeveria mundohet ta mbajë në kontroll këtë pjesë, sepse dëshiron të dalë sa më mirë", -tha Kosiqi.

Voltiza Duro

Gjetja e një vendi pune në ditët e sotme, është shndërruar në një sfidë më vete, veçanërisht për të rinjtë e diplomuar që dëshirojnë të punojnë në profesionin për të cilin kanë studiuar. Në një intervistë ekskluzive për "Gazeta Shqiptare", Rajmonda Kosiqi, doktore e shkencave në fushën e menaxhimit të tregut të punës, me një eksperiencë të gjatë në Zyrën e Punës, tregon të dhëna tronditëse në bazë të një studimi të realizuar në 1690 ndërmarrje private në vend. Kosiqi shprehet se sipas hulumtimeve, plot 60% e punësimeve në Shqipëri bëhen në sajë të njohjeve apo "mikut". Ajo më tej shton se 15% e të rinjve që zotërojnë një diplomë, enden të papunë dhe shpjegojnë të gjithë faktorët ndikues në këtë situatë duke theksuar se shifrat e papunësisë të publikuara nga INSTAT nuk janë reale, pasi ka shumë të papunë të tjerë të padëklaruar.



Rajmonda Kosiqi, doktore e shkencave

tremujorin e dytë 2017, shkalla zyrtare e papunësisë në Shqipëri është 13,9%, ku papunësia për meshkujt rezulton 14,9% dhe për femrat është 12,5%, mund të themi se këto janë shifra zyrtare që kanë dalë nga anketimet e bëra në target grupe të veçanta, ose shifra nga zyrat e punësimit mbi punëkërkuarit e regjistruar pranë këtyre zyrave.


**Pra, shifrat e INSTAT nuk pasqyrojnë realisht shkallën e papunësisë në vend?**

Shifrat e publikuara nga INSTAT nuk paraqesin shkallën e papunësisë që ekziston vërtet në tregun e punës, pasi nuk bëhet evidentimi i të papunëve në të gjithë popullsinë. Ka shumë të tjerë të papunë që nuk dinë ku të orientohen e këshu shifrat e papunësisë janë më të larta sesa ato që jep INSTAT e ne të gjithë jemi të vetëdijshëm për këtë. Vetë qeveria mundohet ta mbajë në kontroll këtë pjesë, sepse dëshiron të dalë sa më mirë.

muar dhe të përgatitur për tregun e punës, të cilët nuk gjejnë mbështetje punësimi në profesionet përkatëse.

Sa prej tyre disponojnë një diplomë universitare?

Duke iu referuar të dhënave, vërehet se Shqipëria është i vetmi vend në rajon, ku papunësia tek të rinjtë me arsim të lartë është më e madhe sesa tek ata me arsim të mesëm. 15% e atyre që kanë mbaruar arsimin e lartë në Shqipëri janë të papunë, në paradoks me ata që kanë mbaruar arsimin e mesëm,



Grafiku i investimit mbi trajnimin e punonjëseve

### Sa prej të papunëve janë të rinjtë?

Një problem shumë shqetësues në tregun shqiptar të punës është shkalla e lartë e papunësisë në grupmoshat e reja. Për të rinjtë e moshës 15-29 vjeç shkalla e papunësisë është 32,8%. Në radhët e këtyre të rinjve të papunë, kemi të bëjmë edhe me studentët të diplo-

ndër të cilët papunësia është 12%, duke treguar një lidhje të zhdrejtë mes të diplomuarve me arsim të lartë dhe kërkesave të tregut të punës. Këto zhvillime në Shqipëri, janë të kundërta me zhvillimet në BE, ku papunësia e atyre që kanë mbaruar arsimin e lartë është vetëm 5%, ndërsa me arsimin e mesëm është 15%.

### Cilat janë disa prej shkaqeve që vështirësojnë gjetjen e një pune për të

#### diplomuarit?

Arsyet janë të shumta duke përmendur këtu nivelin ekonomik gjithnjë e në rënie, mënyrat se si bëhen emërimet, nga politika që ndiqet konkretisht për menaxhimin e burimeve njerëzore e jo vetëm kaq.

Një tjetër shkak është edhe planifikimi jo si duhet i karrierës së të rinjve, që fillon që nga zgjedhja e profilin të studimit, pasi prindërit dhe ata vetë nuk kanë informacion se çfarë kërkesash ka tregu i punës për profesione apo zanane. Një arsye tjetër janë dhe kushtet e papërshatshme të punës dhe pagesat shumë të ulta të pagave mujore që ofrojnë një pjesë e mirë e subjekteve kryesisht fasoneritë.

Një problem shumë i madh për gjetjen e një pune është edhe mungesa e mekanizmave në tregun e

punës që bëjnë përshtatjen e kërkesës me ofertën, kjo gjë është lenë spontanitetit, dhe tregu i punës në Shqipëri rregullohet vetveten.

### Ku drejtohen më tej këta të rinj që nuk arrijnë të sigurojnë një punë në profesionin e tyre?

Ajo që ndodh me rininë shqiptare tashmë është shndërruar në një "ritual" më se normal: ndjekja e një cikli studimesh, diplomimi i tyre me gjithë vështirësitë që hasin në rrugën për tu diplomuar, e më pas periudha e papunësisë. Për shkak të shumë dyerve të mbyllura në pozicione pune brenda profilin të tyre, të rinjtë e diplomuar pranojnë të kryejnë punë të cilat përveçse jashtë profilin të tyre, janë edhe jashtë standardeve të sigurisë dhe shëndetit në punë që duhet të ofrojë një vend pune i denjë. Informaliteti në kushtet e punës kthehet në një procedurë të zakonshme e normale në radhët e tyre.

### Çfarë sjell papunësia në jetën e një të riu?

Ka të rinj që bien dakord me realitetin i cili duhet të jetë i përkohshëm por në dukje nuk është i tillë, ndërsa të tjerë, të cilët përbejnë edhe shumicën i drejtohen rrugëve të tjera. Rritja e kriminalitetit në radhët e të rinjve ka si shtesë me efekt të madh papunësinë. Nga të qenët të punësuar në një vend jashtë kualifikimit të tyre profesional e me pagesa të ulëta, një pjesë e mirë e të rinjve zgje-

### Cili është fokusi i studimit që ju keni realizuar?

Studimin e kam filluar në vitin 2013 dhe ka zgjatur plot 4 vjet e konsiston në analizimin e situatës së tregut të punës në 1690 ndërmarrje në vend, sjellë kjo nëpërmjet pyetësorëve të realizuar në subjekte private të profileve të ndryshme si nga loji i biznesit, ashtu dhe nga numri i të punësuarve. Të dhënat nxjerrin në pah një problem të madh që ka tregu shqiptar i punës, ka një numër të lartë të papunësh, por nga ana tjetër, ka dhe shumë vende të lira pune të deklaruara nga subjekte dhe që janë quajtur "të vështira për t'u plotësuar".

### Si paraqiten shifrat e papunësisë në vendin tonë?

Një ndër problemet më shqetësues në ekonominë shqiptare është mosfunjioni si duhet i tregut të punës. Pavarësisht se sipas raportimit të INSTAT për

Grafiku i kërkesës së vendeve të lira nga kompanitë






Foto ilustruese

dhin emigrimin. Janë të shumta statistikak dhe anketat e kryera në lidhje me aplikimet e 3 viteve të fundit për azil në Gjermani e Francë. Shifrat zyrtare tregojnë se në 3 vjet janë mbi 100 mijë azilkërkuar. Në vitin e fundit kemi mbi 200 mijë aplikime për Green Card. Shpresa tek të rinjtë shqiptarë, fatkeqësisht sa vjen e merr drejtimin jashtë kufirit shqiptar.

**A orientohen siç duhet të rinjtë shqiptarë në kërkesat që ka tregu punës?**

Sipas të dhënave, në Shqipëri vijon të jetë akoma një problem madhor mungesa e statistikave dhe raporteve, të cilat do të orientonin të rinjtë drejt zgjedhjeve të duhura akademike. Kërkesat e kompanive për punonjës, nuk përpunohen me ofertën e individëve në tregun e punës. Dhe kjo disbalancë, vërehet masivisht në degën e juridikut dhe ekonomikut, të cilat vijnë të jenë, zgjedhjet e preferuara të të rinjve shqiptarë por, kur mbarojnë

studimet ndeshen me një terren krejt tjetër të kërkesave për punë që ka tregu. Ndaj të kesh mbaruar arsimin e lartë në Shqipëri nuk do të thotë të jesh i privilegjuar për të gjetur punë, në krahasim me ata që kanë mbaruar të mesmen.

**Sa rol kanë njohjet apo "miku" në gjetjen e një vendi pune në Shqipëri?**

Bazuar në gjetjet e studimit, në mbi 60% të rasteve, mënyra kryesore e gjetjes së një vendi pune është nëpërmjet të afërmeve dhe miqve. Pra, kanalet e rekrutimit si institucionet zyrtare ose njoftimet online janë shumë të kufizuara.

**Cilat janë profesionet që ofrojnë më tepër vende të lira pune?**

Nga studimi i realizuar në 1690 ndërmarrje, nëpërmjet pyetësorëve, profesionet që ofrohen më së shumti janë në industrinë përpunuese kryesisht fasoneritë, që janë konsideruar nga subjektet dhe si pozicione të vështira pune për t'u plotësuar.

**Në bazë të studimit tuaj,**

60%

**E RASTEVE PUNA ME "MIK"**

Bazuar në gjetjet e studimit, në mbi 60% të rasteve, mënyra kryesore e gjetjes së një vendi pune është nëpërmjet të afërmeve dhe miqve. Pra, kanalet e rekrutimit si institucionet zyrtare ose njoftimet online janë shumë të kufizuara.

32.8 %

**TË RINJ TË PAPUNË GRUPOSHIA 15-29 VJEÇ**

Për të rinjtë e moshës 15-29 vjeç shkalla e papunësisë është 32.8%. Në radhët e këtyre të rinjve të papunë, kemi të bëjmë me studentët të diplomuar dhe të përgatitur për tregun e punës, të cilët nuk gjejnë mbështetje punësimi në profesionet përkatëse.

15%

**TË DIPLOMUAR TË PAPUNË PARADOSKI**

15% e atyre që kanë mbaruar arsimin e lartë në Shqipëri janë të papunë, në paradoks me ata që kanë mbaruar arsimin e mesëm, ndër të cilët papunësia është 12%, duke treguar një lidhje të zhdrejtë mes të diplomuarve me arsim të lartë dhe kërkesave të tregut të punës.

1690

**NDËRMARRJE, PROFESIONET E KËRKUARA**

Në 1690 ndërmarrje, nëpërmjet pyetësorëve, profesionet që ofrohen më së shumti janë në industrinë përpunuese kryesisht fasoneritë, që janë konsideruar nga subjektet dhe si pozicione të vështira pune për t'u plotësuar.

**si mund të përkufizohet tregu i punës në vendin tonë?**

Të rinjtë ndryshojnë shpesh statusin nga të punësuar në të papunësuar dhe anasjelltas; ata fillojnë karrierën kryesisht në punë me kualifikim të ulët që shumë shpesh nuk kanë të bëjnë me diplomën e tyre. Kjo praktikë shpesh përfshin kthim pas dhe përzjerje të statuseve të punësuar-student, veçanërisht në kohët aktuale të reformës së arsimit, të krizës ekonomike dhe të turbullirave teknologjike. Këto faktorë e bëjnë analizën e trajektoreve nga shkolla në punë edhe më të vështirë. Tregu i punës rinore në Shqipëri mund të përkufizohet si "fleksibël" dhe "sekuencial".

**A ofrohen trajnime kualifikuese për punonjësit e rinj nga kompanitë që ofrojnë në vendin tonë?**

Në 78% të rasteve, ndërmarrjet e financonin vetë trajnimin, ndërsa 10% merrnin financim nga qeveria. Për pjesën tjetër, punonjësit paguanin vetë për trajnimin. Sipas grafikut të studimit nga totali i kostove të trajnimit, 94% mbulohej nga ndërmarrjet.

**Cfarë mund të bëhet ndryshe për përmirësimin e situatës në tregun e punës?**

Një ndër rekomandimet e

studimit është, kërkesa për të monitoruar vazhdimisht nevojat në ndryshim për aftësi, që kërkon tregu punës.

Duhet t'i kushtohet rëndësi ngritjes së observatorëve të tregut të punës, për të kryer monitorime të vazhdueshme në tregun e punës duke studiuar në mënyrë periodike nevojat e tregut për aftësi dhe pastaj koordinimi me qendrat e formimit dhe institucione të tjera të këshillimit të forcës së punës, siç janë zyrat e punësimin.

**A duhet të forcohen më tej kapacitetet e institucioneve që lidhen me punësimin?**

Është e nevojshme ndërmarrja e veprimeve për të identifikuar dobësitë e institucioneve të tregut të punës; duhen ngritur programe për të shmangur vështirësitë dhe forcur kapacitetet. Siç duket dhe nga intervistimet e bëra në kompanitë e studiuar, nuk ka pothuajse asnjë ndihmë nga institucione të veçanta të formimit apo hallka të tjera shtetërore të menaxhim-

it të tregut të punës, ata çdo iniciativë në drejtim të menaxhimit të stafit e kanë financuar dhe ndërmarrje në mënyrë individuale dhe kjo është një gjetje e rëndësishme e punimit. Institucionet shtetërore të menaxhimit të tregut të punës duhet të hidhen në aksione konkrete e të lidhin fjetet e komunikimit mes subjekteve dhe sistemit të AFP për mirëfunksionimin e dy hallkave kryesore të tregut të punës që janë punëdhënësit dhe punëmarësit.



**Aplikim për të përfutur Statusin e Naftëtarit**

Njoftohen të gjithë punonjësit dhe ish-punonjësit e shoqërisë Albpetrol sh.a se, bazuar në Ligjin Nr.8/2017 "Për Statusin e Punonjësve të Industrisë së Naftës dhe Gazi" dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.425 datë 10.05.2017, se ka filluar shpërndarja e dokumenteve për Statusin e Naftëtarit. Personat e interesuar që të pajisen me dokumentet përkatëse duhet të paraqiten pranë njërit prej qendrave të punës ku kanë punuar dhe të fillojnë procedurën.

Shoqëria Albpetrol sh.a sqaron të gjithë personat e interesuar se disponon dokumentacion për periudhën që kanë punuar në shoqërinë Albpetrol sh.a nga viti 1994 e në vazhdim. Për periudhën përpara vitit 1994, dokumentet mund të merren pranë Sigurimeve Shoqërore ose arkivave të tjera.

Personat që duan të pajisen me vërtetim të posaçëm zyrtar për periudhën përkatëse duhet të plotësojnë formularin përkatës, i cili mund të shkarkohet në adresën [www.albpetrol.al/statusi-i-naftetarit/](http://www.albpetrol.al/statusi-i-naftetarit/) ose mund të tërhiqet fizikisht pranë qendrave ku kanë punuar.

Formulari i plotësuar duhet të dorëzohet në qendrat ku keni punuar së bashku me një kopje të librezës të punës ose mund të dërgohet me postë në qendrën përkatëse.

**Kosiqi: Po provoj "në kokën time" gjetjet e studimit**

"Kam aplikuar për punë, s'më kanë kontaktuar"

Rajmonda Kosiqi, doktoreshkencave në menaxhimin e tregut të punës, tregon edhe vështirësitë me të cilat po përballon vetë për të gjetur një vend pune, pas njoftimit mbi largimin nga puna brenda 31 dhjetorit të këtij viti. "Unë kam një eksperiencë 15-vjeçare në fushën e funksionimit të tregut të punës, pasi kam punuar pranë Zyrës Rajonale të Punësimin në Tiranë, pas kësaj përvojë pune kam punuar për 6 vite si Drejtore Drejtorie pranë Agjencisë Komitetare të Burimeve Natyrore dhe aktualisht jam në afatet e njoftimit për zgjidhje të marrëdhënieve të punës për shkak të të ashtuquajturës "reformë" që po bën qeveria në administratë, me pretekstin e "rstrukturimit".

Me pak fjalë, tashmë jam në pozicionin e një punëkërkuar, tregon ajo. Më tej, Kosiqi thotë se I është dashur që të aplikojë në disa subjekte private për të gjetur një vend pune, por deri më tani nuk ka marrë asnjë përgjigje. "Kam aplikuar në shumë vende, por nuk kam marrë asnjë konfirmim, qoftë edhe për një intervistim, edhe pse mendoj që kam një cv të plotësuar me kualifikimet e nevojshme", shton më tej doktorja e shkencave në menaxhimin e tregut të punës. Ajo thotë se po vërteton personalisht konkluzionet e hulumtimit që konsistojnë në gjetjen e një vendi pune vetëm nëpërmjet njohjeve, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat.

**Policia: Sekuestrohen 13.5 tonë kanabis**

**Tentoi të trafikojë drogë drejt Greqisë, arrestohet 36-vjeçari**

**PËRMET** - Policia e Shtetit gjatë një operacioni antidrogë të zhvilluar në Përmet, ka sekuestruar 13.5 kg kanabis. Në kuadër të këtij operacioni ka rënë në pranga shtetasi Joan Haska. Bëhet me dije se në Pikën Kufitare Tre Urat, Përmet, shërbimet e Policisë Kufitare në bashkëpunim me shërbimet doganore kanë evidentuar dhe goditur një rast të tentativës për trafik të lëndëve narkotike. Në dalje të Republikës së Shqipërisë është

paraqitur shtetasi Joan Haska me automjetin me targa AA 190 CN. Pas përfundimit të procedurave të kontrollit të dokumentacionit, punonjësit e Policisë Kufitare, e kanë kaluar automjetin në vijën e dytë për një kontroll më të imtësishtëm. Gjatë kontrollit të ushtruar në vijën e dytë, në një vend të përshatur në shasinë e mjetit u gjet lëndë e dyshuar narkotike Cannabis Sattiva. Peshatotale e lëndës rezultoi 13.5 kg, e cila u sekuestrua në cilësinë e provës materiale. Nga specialistët e seksionit



të Hetimit të Narkotikëve në D.V.P Gjirokastër u bë arrestimi në flagrancë i shtetasis: Joan Haska, 36 vjeç, banues në fshatin Mashkullorë, Gjirokastër. Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Përmet për veprën penale "Trafikimi i narkotikëve".

**Ranë në pranga Arkid Sakiu dhe Gramoz Ismailaj**

**Trafikuan 42 kg drogë në Itali, zbulohen emrat e shqiptarëve**

**ITALI** - Mediat italiane bëjnë publik identitetin e dy shqiptarëve të cilët ranë në pranga një javë më parë pasi u kapën me drogë në parkingun e një qendre tregtare. Mësohet se identiteti i të rinjve u bë i ditur pas daljes në gjykatë. Më 6 dhjetor dy shqiptarët u arrestuan pasi u kapën me 42 kilogramë drogë marijuanë. Mediat e huaja bëjnë me dije se ata ende nuk kanë thënë asnjë fjalë në lidhje me ngjarjen duke ua vesh-tirësuar punën au-

toriteteve italiane. Shqiptarët e arrestuar janë Arkid Sakiu, 28 vjeç banues në Tagliamento dhe bashkëmohatari i tij Gramoz Ismailaj, banues në Savona. Dy të rinjtë ranë në pranga mbrëmjen e datës 6 dhjetor nga karabinierët e Porde-nones. Ndalimi i tyre u bë në parkingun e një qendre tregtare për shkëmbimin e drogës. Bashkë me ta janë ndaluar edhe tre italianë nga Brindisi. Konkretisht Pietro Buzzerio, 53 vjeç; Francesco Angelini, 39 vjeç dhe Domenico Spano, 43



vjeç. Ditën e shtunë ata kanë dalë para gjykatës, por asnjëri nuk ka reaguuar përpara trupës gjyqësore në lidhje me këtë ngjarje. Sakaq policia italiane vazhdon hetimet për zbardhjen e plotë të ngjarjes dhe për përfshirjen e personave të tjerë në këtë rrjet.

Flet arbitri, Qerim Ruçi: Ditët e fundit ishte shumë i heshtur, pothuajse nuk fliste fare

Ina Allkanjari

SARANDE

Trupi i pajetë i shtetasi Agim Proda është gjetur i djegur ditën e djeshme në brendësi të ashensorit të një pallati në Sarandë. 58-vjeçari Proda, punonjës i Ujësllëstit të këtij qyteti dyshohet të jetë vetëdjegur. Akti i rëndë mendohet të jetë kryer në kushet e depresionit. Burime për "Gazeta Shqiptare" bëjnë me dije se Proda ka qenë ish-arbitër ndërkombëtar i FIFA-s në vitet 86-88, ndërsa në vitet e fundit ishte vëzhgues i ndeshjeve të futbollit shqiptar. Presidenti i FSHF, Duka i ka shprehur ngushëllimet familjes për ndarjen nga jeta të Agim Prodës. Ndërkohë arbitri i kategorisë së dytë në Sarandë, Qerim Ruçi, i pyetur nga "GSH" në lidhje me këtë ngjarje të rëndë, është shprehur se me të ndjerin ka pasur kontakte të vazhdueshme prej vitesh, kjo pasi i lidhte qyteti ku jetonin dhe profesionin. Duke shprehur ngushëllimet për largimin nga jeta të personit që e kish përkrahur për një kohë të gjatë dhe falë të cilit Ruçi sot është arbitër pranë FSHF-së, i riu tregon se Proda prej ditësh kishte shfaqur shenja depresioni. "Më erdhi shumë keq kur dëgjova lajmin tragjik të ndarjes nga jeta të një prej njerëzve që më kanë përkrahur në pasionin dhe njëkohësisht profesionin tim. E takoja thuasje përditë, por kohët e fundit nuk ishte mirë, nuk fliste pothuajse fare dhe ishte në gjendje shumë të ngarkuar psikologjike. Nuk e mendonim që do shkonte deri në këtë pikë", u shpreh arbitri nga Saranda, Qerim Ruçi, për "Gazeta Shqiptare".

**Gjendet i djegur në ashensor vëzhguesi i ndeshjeve të FSHF-së**

**Policia: Agim Proda mund të jetë vetëvrarë**



**ARBITRI**

"E takoja thuasje përditë, por kohët e fundit nuk ishte mirë, nuk fliste pothuajse fare dhe ishte në gjendje shumë të ngarkuar psikologjike. Nuk e mendonim që do shkonte deri në këtë pikë", u shpreh arbitri nga Saranda, Qerim Ruçi, për "Gazeta Shqiptare".

**HETIMI**

Policia e Sarandës bën njoftimin se ditën e diel, rreth orës 14:10, është lajmëruar salla operative nga një telefonatë se në lagjen "Nr4", në brendësi të ashensorit të një pallati, i cili ishte ende në ndërtim është gjetur plotësisht i djegur trupi i një shtetasi. Shërbimet policore dhe grupi hetimor kanë shkuar menjëherë pranë vendit të ngjarjes dhe kanë konstatuar se në brendësi (në gropën) e ashensorit gjendet plotësisht i djegur trupi i një shtetasi të seksit mashkull. Nga veprimet paraprake të kryera dyshohet se trupi i pajetë t'i përkasë shtetasis Agim Proda, 58 vjeç, banues në Sarandë, i cili mund të jetë vetëdjegur.

**MESAZHI I FSHF**

FSHF dhe presidenti Armand Duka shprehin ngushëllimet e tyre më të sinqerta për ndarjen e parakohshme nga jeta të një prej bashkëpunorëve më të ngushtë për zonën e jugut dhe jo vetëm, vëzhguesit të saj Agim Proda, njëherësh edhe ish-arbitër ndërkombëtar i FIFA-s në vitet 86-88". Me hidhërim shumë të madh FSHF ka

mësuar lajmin për ndarjen nga jeta të kolegut Proda në moshën 58-vjeçare. Z.Proda gjatë gjithë këtyre viteve ka kryer funksionet e vëzhguesit të ndeshjeve në garat e futbollit shqiptar. FSHF përcjell ngushëllimet e saj për familjarët, të afërmit dhe miqtë e Agim Prodës duke mbajtur njëherësh në kujtesë të gjatë kontributin e tij të vazhdueshëm në futbollin shqiptar.

**Trafikuan 2.5 tonë drogë drejt Italisë, zbulohen rolet e anëtarëve të grupit kriminal**

Zbulohen rolet e anëtarëve të grupit kriminal të cilët trafikuan 2.5 tonë drogë në janar të këtij viti nga porti i Durrësit drejt Italisë. Në kuadër të këtij operacioni kanë rënë në pranga 12 persona. Hetimet e Krimëve të Rënda kanë arritur të zbërthejnë të gjithë grupin dhe rezultojnë se në krye të bandës kriminale qëndronin nënkomisari i policisë Festim Lelaj dhe shtetasi Euron Hoti. Oficeri i policisë siguronte mosprekjen e drogës nga aksionet e policisë. Ndërsa Hoti kishte siguruar dy kamionë me lëndë drusore me qëllim transportin drejt Gjermanisë, aty ku ishte dhe destinacioni përfundimtar i drogës, deklaroi Klan Tv. Pritësi i lëndës narkotike ishte pikërisht Hoti, i cili mbante edhe një emër tjetër, atë të Artan Abasit. Ai përdorte një pasaportë angleze të falsifikuar dhe hijej si shqiptar nga Kosova. Shofer i kamionit ishte Dhimo Koraj, i cili u arrestua në Itali pasi kamioni me drogë doli nga Porti i Ankonës. Dy efektivat e policisë në Portin e Durrësit Agron Kallanaj e Gëzim Dervishi si dhe dy doganierët Altin Katundi si dhe Mikail Hila kanë neglizhuar me detyrën duke lejuar kalimin e drogës. Prokuroria i konsideron veprimet e qëllimshme dhe i konsideron si pjesë të grupit. Skënder Siceqa dhe Aurel Lazaj dyshohet se kanë trafikuar një tjetër ngarkesë që po i njëjti grup ka kaluar nga Porti i Vlorës në vitin 2014. Në këtë kohë punonjës policie në këtë pikë kufitare ka qenë nënkomisari Lelaj. Tre të arrestuarit e tjerë Arbi Mustafa dhe Malton Lleshi dyshohet se kanë siguruar lëndën narkotike, kryesisht në zonën e Vlorës.





## SHKAKTARËT KRYESORË TË AKNEVE



Ylli Merja: Vaji i rignonit, kurues i fuqishëm ndaj infeksioneve në fytyrë

## OKULISTJA MIMOZA MEÇO



10 këshilla të thjeshta për të mbrojtur shikimin tuaj

# Klevis Thomai:

◆ Mjeku otorinolaringolog:  
Cilat janë shenjat e para, këshilla për evitimin e situatave



## Kujdes nga "trupat e huaj" në rrugët ajro-ushqimore

"Mund të ketë pasoja fatale për fëmijët"

• Pini çaj mente për forcimin e imunitetit. Lakra e kuqe, rregullator i sistemit tretës

**Mjeku otorinolaringolog: Cilat janë shenjat e para, këshilla për evitimin e situatave**

# Klevis Thomai:

## Kujdes nga "trupat e huaj" në rrugët ajro-ushqimore

*"Mund të ketë pasoja fatale për fëmijët"*

Voltiza Duro

Shumë pacientë nuk e kanë dëgjuar asnjëherë termin "trup i huaj" deri në momentin që balafaqohen me një situatë të tillë shëndetësore. Trupat e huaj në rrugët e tretjes, dhe sidomos ata në rrugët ajrore, janë nga urgjencat më të rëndësishme dhe jetëkërcënuese për fëmijët, por dhe mjaft shqetësuese për prindërit dhe vetë personelin mjekësor. Në një intervistë ekskluzive për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare" mjeku otorinolog pranë QSUT-së, Klevis Thomai, tregon hapat kryesorë që duhen të ndjekin prindërit në raste urgjencash madhore në të tilla situata si dhe shenjat e para që paralajmërojnë se fëmijët mund të kenë gëlltitur "trupa të huaj". Mjeku më tej paralajmëron se kujdesi që duhet të tregohet për fëmijët në këto raste duhet të jetë maksimal, pasi degradimi i situatës mund të jetë fatal për vogëlushët.

**Cfarë janë trupat e huaj?**

Trupat e huaj mund të jenë lodra ose pjesë lodrash të ndryshme, bateri të vogla, monedha, bizhuteri, para-manda, dhembët e vetë fëmijëve, dhe ushqime si kikirikë, stika, arra, fasule, bizele, etj.

**Ku mund të mbeten këta trupa në momentin që gëlltitet nga fëmija?**

Këta trupa të huaj mund

**KËSHILLA PËR PRINDËRIT:**

- Mbatja nën vëzhgim të vazhdueshëm të fëmijëve kur ata kanë në dorë objekte me rrezikshmëri të shtuar
- Respektimi i kufirit të moshës në etiketat e lodrave
- Hedhja e lodrave të thyera
- Mosdhënia e monedhave në dorë të fëmijëve nën 7 vjeç
- Mosushqyerja e fëmijëve të cilëve nuk u kanë dalë dhëmballët me kikirikë, arra, stika farëra.

të ngecin në hundë, fyt, laring, brenda mushkërisë, dhe ezofag. Dëmet prej tyre mund të jenë të pariparueshme dhe ndonjëherë fatale.

**Cfarë shenjash jep një trup i huaj në rrugët aerodigestive?**

Një trup i huaj në ezofag jep dhimbje kraharori, shtim të sekrecioneve të pështymës (jargë nga goja), të vjella ose ndjenjën e të vjellave, pamundësinë e kalimit të ushqimeve në stomak, ndonjëherë dhe vështirësi në frymëmarrje.

**A paraqitet e lartë shkalla e vështirësisë në këto situata për mjekët?**

Trupat e huaj në rrugët e frymëmarrjes janë situata mjaft të vështira për pacientët dhe vetë



Mjeku otorinolog, Klevis Thomai

personelin shëndetësor. Ato karakterizohen me vështirësi në frymëmarrje, e cila mund të jetë e lehtë deri në bllokim të plotë të frymëmarrjes, me nxirje të buzëve, axhitim të theksuar ose humbje të vetëdijes; situatë kjo që quhet 'dramë laringeale'. Shoqërohet me kollë, marrje fryme, zhurma jo normale gjatë frymëmarrjes (fërshëllima), dhe në disa raste bllokime të here pas here shme të frymëmarrjes. Me kalimin e ditëve mund të shfaqen shenjat tipike të një ftohje të rëndë.

**C'mund të bëhet në shtëpi në raste urgjencash madhore?**

Hapi i parë është kontrolli i gojës për ndonjë trup të huaj, i cili bllokon hyrjen e fytit. Më pas duhet aplikuar manovra Heimlich, e cila ka për qëllim nxjerrjen e trupit të huaj

nëpërmjet presionit të ajrit që ndodhet brenda mushkërive. Kjo realizohet duke shtypur fort kraharorin e fëmijës, për vogëlushët nën dhe mbi 2 vjeç. Ndonjëherë mund të nevojitet dhe frymëmarrja gojë më gojë për të fituar kohë deri në dërgimin e fëmijës në spital.

**Si realizohet heqja e trupave të huaj?**

Heqja kirurgjikale (endoskopike) kryhet vetëm pranë Qendrës Spitalore Universitare Tiranë, në Shërbimin ORL. Të gjithë fëmijët, të cilët kanë problem me frymëmarrjen dhe tek të cilët dyshohet se mund të ketë ngelur trup i huaj duhet t'i drejtohen me urgjencë shërbimit Pediatrik dhe ORL të QSUT.

**Cilat janë disa nga rekomandimet tuaja për prindërit për evitimin e rasteve të tilla?**

Duke parë rrezikshmërinë e këtyre situatave, shihet me vend, në këtë rast më shumë se çdo tjetër, parandalimi i tyre nëpërmjet mbajtjes nën vëzhgim të vazhdueshëm të fëmijëve kur ata kanë në dorë objekte me rrezikshmëri të shtuar. Gjithashtu, duhet treguar kujdes në respektimin e kufirit të moshës në etiketat e lodrave si dhe në hedhjen e lodrave të thyera. Prindërit nuk duhet t'i japin monedha në dorë fëmijëve nën 7 vjeç si dhe për të gjithë vogëlushët që ende nuk u kanë dalë dhëmballët, duhet të mos i ushqejnë me kikirikë, arra, stika farëra.

Infeksionet bakteriale mund të merren në sallonet e bukurisë, kur përdoren furça të njëjta dhe nuk dezinfektohen nga njëri person tek tjetri. Gjithashtu, këto infeksione mund të merren kur preket fytyra me duar të palara, sidomos në ambiente publike. Ose mund të merren nga pastrimi i fytyrës me mjete të padezinfektuara. Shumë infeksione merren edhe te dentisti.



Mjeku Ylli Merja



Mjeku popullor: Ja cilët janë shkaktarët kryesorë në krijimin e akneve, llojet e tyre

# Ylli Merja: Vaji i rigonit, kurues i fuqishëm ndaj infeksioneve në fytyrë

*"Si duhet të kujdeseni për lëkurën tuaj"*

Në lëkurë ka gjëndra dhe pore, ku gjëndrat prodhojnë yndyrë, dhe nëse çekuilibrohet prodhimi i yndyrës, që vjen si shkak i çrregullimit hormonal, atëherë prodhohet lëkura me shumë yndyrë. Pastaj nga mungesa e higjienës në lëkurën e yndyrshme, ngjiten bakterie dhe mikrobe nga ajri dhe shkaktojnë puçrra. Infeksionet bakteriale mund të merren në sallonet e bukurisë, kur përdoren furça të njëjta dhe nuk dezinfektohen nga njëri person tek tjetri. Gjithashtu, këto infeksione mund të merren kur preket fytyra me duar të palara, sidomos në ambiente publike. Ose mund të merren nga pastrimi i fytyrës me mjete të padezinfektuara. Shumë infeksione merren edhe te dentisti, madje të gjitha llojet e kontaktit me anë të gjakut mund t'ju shkaktojnë infeksione që çojnë në formimin e puçrrave. Bakteri që jeton në lëkurën e çdo njeriu i lokalizuar në rrënjën e qimeve quhet Propionibacterium acnes, dhe ushqehet me yndyrën e lëkurës dhe qelizat e vdekur. Prandaj kur rritet yndyra në lëkurë, rritet edhe sasia e këtij bakterie në fytyrë. Ky bakter sekretion substancë që e tretin yndyrën e lëkurës dhe e ndihmojnë të rritet. Kur ky bakter shumohet më tepër sesa duhet, sistemi imunitar e lufton dhe prandaj formohet zona të inflamuar fillimisht dhe pastaj pasi ngacohen krijon më shumë zona të inflamuar. Më tej, Staphylococcus është një tjetër bakter që shkakton infeksione në lëkurë dhe akne cistike, gjithashtu, ai jeton në lëkurën e çdo individi.

3 nga 4 njerëz në botë janë të prekur nga aknet, nga mosha 11-30 vjeç. Disa nga llojet e akneve janë: akne cistike, akne postule, ato papule dhe pikat e zeza ato të bardha.

**SHKAQET E FORMIMIT TE AKNEVE:**

- Bllokimi i poreve
- Shtesë e prodhimit të vajit sebum
- Bakteret
- Hormonet ( rritja e nivelit të androgjenit në adoleshencë
- Dieta të pasura me shumë sheqer dhe karbohidrate
- Ushqimet me yndyrë
- Kontraceptivët që parandalojnë shtatzëninë
- Konsumi i tepërt i çokolllatës
- Steroidet që përdoren për rritjen e muskujve
- Produktet e qumështit pasi përbajnë Bovine -hormoni i rritjes dhe nxisin gjëndrat e yndyrës të prodhojnë më shumë yndyrë, duke nxitur aknet.
- Stresi rrit nivelin e androgjenit në organizëm, i cili nxit gjëndrat e yndyrës të prodhojnë më shumë yndyrë dhe kështu bllokohen poret. Gjithashtu, lëkura nuk rigjenerohet lehtë kur trupi është nën stres.

**LLOJET E AKNEVE:**

- Pikat e zeza formohen kur bllokohen poret në lëkurë dhe ngelet nën lëkurë sebumi dhe baktere të ndryshme.
- Pikat e bardha formohen nga bllokimi i sebumit nën lëkurë dhe lëkurës së vdekur. Nuk përmban baktere pasi poret janë komplet të mbyllura, nuk ka kontakt me mjedisin e jashtëm.
- Aknet inflamatorë ndryshe pikat e kuqe dhe të fryra në lëkurë disa nga arsytet e krijimit të tyre janë bakteret, ndryshimet hormonale.

- Nodulet janë aknet që kanë infektion dhe janë të inflamuar, të fryra dhe të skuqura. Kanë rrënjë të thella nën lëkurë.
- Cistet formohen kur bllokohen poret dhe bakteret ngelen nën lëkurë, dhe zhvillohen.

**KURAT QË PËRDOREN ZAKONISHT KUNDËR AKNEVE:**

- 1) Acidi salicilik i cili ul inflamacionin, largon pikat e zeza duke i hapur poret.
- 2) Acidi benzoik që vret bakteret, ndalon prodhimin e sebumit Sulfur- antibakterial
- 3) Vajra të fortë antibakteriale si vaj rigoni dhe vaj nga bima e çajit.
- 4) Vitamina A- retinoide, të cilat hapin poret dhe i ndihmojnë në pastrimin e tyre.

**KUJDESI PERSONAL:**

- Lajeni fytyrën 2 herë në ditë
- Mos e prekni me duar gjatë ditës dhe largojini flokët nga fytyra
- Përdorni make-up që nuk i bllokton poret e lëkurës
- Mos i prekni aknet që janë në lëkurë sepse shtohen
- Mos përdorni shumë kafe dhe sheqer
- Lajeni fytyrën para se të flini
- Përdorni krem hidratant në dimër dhe krem mbrojtës në verë

# Okulistja Mimoza Meço: 10 këshilla të thjeshta për të mbrojtur shikimin tuaj

**Q**ëndrimi i gjatë para kompjuterit e pa pjesëve elektronike, kalimi i moshës, mospërdorimi i syzeve mbrojtëse dhe sëmundjet e trashëguara, janë disa nga faktorët kyç, që dëmtojnë shikimin tuaj. Mjekja okuliste, Mimoza Meço, tregon për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare" 10 këshilla të vlefshme sesi të mbrohi sytë tuaj.

## 1. Përdorni kompjuterin siç duhet

Nëse keni një punë që deterohehi të qëndroni me orë të zgjatura në kompjuter, së pari duhet të bëni pushime të shkurtra 2-3 minuta çdo gjysmë ore dhe mbi 15 minuta çdo 2-3 orë. Ndriçimi i ekranit nuk duhet të jetë i lartë dhe distanca nga ekranit të jetë rreth 60 cm. "Kujtohuni" të bëni pulitje (hapje-mbyllje) të syve, pasi proceset që "marrin" vëmendjen tonë, në mënyrë reflektore, rrallojnë pulitjet e syve.

## 2. Ndriçimi i duhur

Kur lexojmë një libër ose materiale të printuara, ndriçimi i ambientit duhet të jetë i mirë. Leximi në ndriçim të dobët e lodh me shpejt syrin.

## 3. Përdorni lubrifikantë për syrin

Nëse për shkak të ambientit të punës, ose të gjendjes së syrit tuaj, i ndjeni "sytë të thatë", përdorni vazhdimisht lubrifikues artificiale, pasi kjo do të evitohet rëndimin e gjendjes si dhe sëmundje të rëndësishme që lidhen me "syrin e thatë".

## 4. Mos harroni syzat mbrojtëse

Përdorni syza dielli mbrojtëse, pasi ne, si vend mesdhetar, kemi sasi të konsiderueshme rrezatimi UV. Tregoni kujdes që syzat e diellit, të kenë patjetër filtra UV mbrojtës, ky filter nuk ka lidhje me ngjyrën.

## 5. Pozicioni i rregullt gjatë leximit

Tregoni vëmendje ndaj pozicionit që mban fëmija juaj në tavolinë kur bën detyrat. Devijimi i trupit, i pozicionit të kokës, apo koka shumë e ulur, janë një "sinjal" se mund të ketë problem të syve dhe duhet të kryhet një vizitë tek okulisti. Fëmija duhet të këshillohet vazhdimisht që të mbajë një pozicion të rregullt gjatë leximit, në të kundërt, devijimi i shtyllës kurriore mund të bëhet i përhershëm.

## 6. Vizitoni fëmijën tuaj

Fëmijët që fillojnë klasën e parë, e kanë të detyruar



Okulistja Mimoza Meço



Mos lejoni që fëmijët të ekspozohen në mënyrë abuzive, me mjetet elektronike. Syri i fëmijës ende nuk është maturuar dhe biologjikisht nuk është në gjendje të përballojë këtë lloj sforcimi. Prindër, kjo nuk është mënyra e duhur për të "blerë" kohë.

kryerjen e vizitës për sytë. Kjo vizitë shërben si një "filter" për të kapur në kohën e duhur probleme të mundshme të syve.

## 7. Kujdes nga pajisjet elektronike

Mos lejoni që fëmijët të ekspozohen në mënyrë abuzive, me mjetet elektronike. Syri i fëmijës ende nuk është maturuar dhe biologjikisht nuk është në gjendje të përballojë këtë lloj sforcimi. Prindër, kjo nuk është mënyra e duhur për të "blerë" kohë.

## 8. Kontrolloni numrin e syzave

Nëse numri juaj i syzave pëson ndryshime progresive, të shpesh-


ta, drejtohuni në një qendër të specializuar, për ekzaminime të mëtejshme, pasi mund të ketë sëmundje të tjera shoqëruese, përveç numrit të syzave.

## 9. Mos neglizhoni vizitat

Nëse mjekoheni për sëmundje të përgjithshme të trupit si: diabet, hipertension, probleme me veshkat etj., kryeni rregullisht vizitën e syve, një herë në vit.

## 10. Trashëgimia për sëmundjet e syve

Nëse keni trashëgimi për sëmundje të syve, si Glaukome (sëmundje e tensionit të syrit), bëni kontrolle të rregullta, sidomos pas moshës 45-50 vjeç.



Tregoni vëmendje ndaj pozicionit që mban fëmija juaj në tavolinë kur bën detyrat. Devijimi i trupit, i pozicionit të kokës, apo koka shumë e ulur, janë një "sinjal" se mund të ketë problem të syve dhe duhet të kryhet një vizitë tek okulisti. Fëmija duhet të këshillohet vazhdimisht që të mbajë një pozicion të rregullt gjatë leximit, në të kundërt, devijimi i shtyllës kurriore mund të bëhet i përhershëm.





# Këshilla



## Pini çaj mente për forcimin e imunitetit

Çaji i mentes është një ndër pijet më të shijshme e shumë i thjeshtë në përgatitje, por që mbart edhe vlera të shumta shëndetësore. Kjo bimë shërben si një nxitës i mirë në tretje, e nëse vuani nga probleme të tilla, mjafton të pini një gotë çaji mente për t'u ndjerë më mirë.

Gjethet e mentes janë të pasura me antioksidantë dhe fitoushtrues që i vijnë në ndihmë stomakut dhe përmirësojnë tretjen. Gjatë stinës së ftohtë të dimrit, çaji i mentes është tejet hidratues për trupin dhe parandalon një sërë problemesh që vijnë nga dehidratimi apo ataku në zemër. Për të gjithë ata persona që vuajnë nga era e keqe e gojës, zverdhja e dhëmbëve e që paraqesin probleme me shëndetin dentar, këshillohet që të pinë këtë çaj, pasi gjethet e mentes freskojnë natyrisht gojën e luftojnë bakteret dhe inflamacionin ndaj rekomandohen kundër infeksioneve dentare. Mentoli tek mentja çel rrugët e frymëmarrjes dhe e lehtëson atë. Në lëng mund të shtoni gjethë shtesë, të cilat mund t'i kafshoni dhe të çlirohni nga kolla e sekrecionet. Aroma e fortë, shija dhe antioksidantët tek gjethet e mentes e bëjnë

këtë pije ideale edhe kundër stresit si dhe janë të pasura me vitaminat C, D, E, por edhe kalcium, fosfor dhe sasi të vogla të vitaminave të kompleksit B, të cilat forcojnë imunitetin dhe mbajnë larg inflamacionin. Mentja përmban acid rosmarinik që është një antioksidant i fuqishëm. Ai bllokun substancat alergjike në organizëm dhe u vjen në ndihmë njerëzve që preken nga alergjitë e lehta, që kanë rrjedhje hundësh dhe vuajnë nga astma. Ekstraktet e mentes përdoren si



balsam për lëndime të ndryshme në lëkurë, për arsye të efektit të menjëhershëm qetësues dhe mpirës që kjo bimë jep. Rrjedhimisht mentja ndihmon kundër dhimbjes.



## Lakra e kuqe, rregullator i sistemit tretës

Lakra e kuqe është pjesë e tryezave shqiptare e është pjesë e atyre perimeve të shijshme që mund të hahet e gjallë apo e gatuar. Kjo perime mbart vlera të fuqishme shëndetësore pasi është e pasur me fibra që ndihmojnë në parandalimin e konstipacionit dhe rregullimin e sistemit tretës. Lakra e kuqe përmban 85% të dozës ditore të vitaminës C duke e renditur më lart sesa portokallet për nivelin e kësaj vitamine. Për më tepër, lakra e kuqe është nga ato të pakta perime me nivelin më të ulët të mbetjeve të pesticidëve në lëkurën e saj. Lakra e kuqe ka 10 herë më shumë vitaminë A se lakra e bardhë, ndërsa kjo e fundit ka dy herë më shumë vitaminë K se sa lakra e kuqe. Kur vjen puna te hekuri, lakra e kuqe ka dyfishin në krahasim me lakrën e bardhë. Sa i përket antioksidantëve, lakra e kuqe është superiore. Konsumimi i lakrës së kuqe stimulon qelizat e bardha duke krijuar një sistem të fortë mbrojtës në organizmin tonë. Sistemi imunitar është jashtëzakonisht i ndjeshëm ndaj raportit të oksidantëve dhe antioksidantëve, duke qenë se prodhimi i pakontrolluar i radikaleve të lira, mund të dëmtojë sistemet e mbrojtjes. Radikalet e lira prodhohen në trup dhe dëmtojnë qelizat. Antioksidantët janë mekanizmat më të mirë mbrojtjes dhe përzënë nga trupi të gjithë qelizat e dëmshme. Lakra e kuqe ka aq shumë vitaminë C sa që është një nga ushqimet me nivel më të lartë antioksidantësh në të gjithë zinxhirin ushqimor. Kjo perime ka elemente të rëndësishme që luftojnë inflamacionin. Shkencëtarët kanë provuar që konsumimi i lakrës së kuqe ka një efekt pozitiv në reduktimin e ënjtjeve. Inflamacioni mund të shkaktojë dhimbje dhe ënjtje në kyçe dhe gjymtyrë, ndaj një dietë e pasur me fruta dhe perime përfshirë lakrën e kuqe është e nevojshme. Por lakra e kuqe është e njohur edhe në aftësitë e saj çudibërëse në kurimin e osteoporozës. Sëmundjet kronike si Alzheimeri, Huntington, Parkinson etj. prekin 45 milionë njerëz në botën duke dëmtuar qelizat e trurit në mënyrë progresive deri në shkatërrimin e tyre, por lakra e kuqe ka antioksidantë të pasur që parandalojnë ose kthejnë mbrapsht dëmtimet në ADN.

**LETRA**

# Dekani i ri i Histori- Filologjisë i shkruan Ramës dhe Nikollës: Po tentohet të ndryshohet rezultati i votimit

Nga Prof. Dr. Sabri Laçi

*(Vljon nga faqja e parë)*

... nga Komisioni i Zgjedhjeve në FHF, i është drejtuar me një letër kryeministrit Edi Rama dhe ministres Lindita Nikolla. Në këtë letër, shkruan se duhet të vihen në dijeni "të disa ngjarjeve të rënda që kanë ndodhur gjatë këtij procesi, të cilat mendoj se kanë rëndësi jo vetëm për fakultetin tonë, por për gjithë sistemin universitar".

**LEXOJENI TË PLOTË LETRËN**

Letër drejtuar ministres së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë Znj. Lindita Nikolla  
Për dijeni zotit Edi Rama, Kryeministër i Republikës së Shqipërisë

E nderuar Zonja Ministre,  
Unë që po ju shkruaj jam Sabri Laçi, profesor në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës, kandidat për postin e dekanit të fakultetit, i shpallur fitues pas përmbyljes së numërimit të votave nga KZF (Komisioni i Zgjedhjeve në FHF).

Po Ju drejtohem për t'ju vënë në dijeni të disa ngjarjeve të rënda që kanë ndodhur gjatë këtij procesi, të cilat mendoj se kanë rëndësi jo vetëm për fakultetin tonë, por për gjithë sistemin universitar.

Kur vendosa të futesh në garë, mendova se po hyj në një proces të ndershëm zgjedhor universitar, i bindur se pedagogët dhe studentët meritojnë standarde zgjedhore të larta dhe një proces që do të ndikonte pozitivisht në të ardhmen e institucionet tonë arsimor. Bëra një garë të ndershme i bindur se institucionet që garantojnë



zgjedhjet do të ishin garanci për ruajtjen e standardeve të zgjedhjeve.

Fatkeqësisht këto institucione nuk e bënë një gjë të tillë. Si KZF ashtu edhe KIZ (Komisioni Institucional zgjedhor) u përfshinë në tentativën për manipulimin e rezultativit të zgjedhjeve që pa nisur procesi. KIZ përjashtoi në mënyrë arbitrare në kundërshtim me ligjin një pedagog, personel akademik me kohë të plotë nga pjesëmarrja në zgjedhje. Gjatë zgjedhjeve përfaqësues të KIZ u kanë bërë presione studentëve që të mos marrin pjesë në zgjedhje, duke krijuar tension. Ndërkohë, që me fillimin e procesit u verifikua se KZF u ka dhënë pedagogëve fletë studentësh për të votuar,

duke i shpallur më pas vota të tilla si të pavlefshme. I njëjti komision largoi në kundërshtim me ligjin vëzhguesit nga procedura e numërimit të votave dhe më pas, kur e panë që rezultati ishte në favorin tim, bllokuan procesin, i cili u zhblokua pas angazhimit të përfaqësuesve të Forumit për Autonominë Universitare dhe Liritë Akademike, të cilët e gdhinë natën në fakultet në mbrojtje të votës së kolegëve dhe studentëve.

Pasi dështoi tentativa për manipulimin e procesit zgjedhor në KZF, KIZ si gjithnjë konsekuente në përpjekjet për deformimin e procesit zgjedhor, është mbledhur pa dijeninë e kandidatëve dhe të përfaqësuesve të tyre si vëzhgues

dhe po tenton të vejë në diskutim mandatin, fillimisht përmes rinumërimit, i cili ka konfirmuar saktësisht kandidatin fitues. Tani po kërkojnë të venë në diskutim formulën e llogaritjes së votave të studentëve, e cila është përcaktuar saktësisht në Rregulloren e Zgjedhjeve në Institutet e Arsimit të Lartë, e zbatuar në zgjedhjet e mëparshme.

E nderuara ministere. Duke besuar plotësisht në ndjeshmërinë dhe përgjegjësinë Tuaj në garantimin e votës së lirë të pedagogëve dhe studentëve, Ju lutem ndërhyni që të paktën në universitet të mos përhapet dukuria e shkatërrimit të procesit zgjedhor.

Me konsideratën më të lartë  
Prof. Dr. Sabri Laçi

**HOROSKOPI**

**DASHI**  
Duke u treguar të gatshëm të konfrontoheni me të dashurin tuaj për të sqaruar një keqkuptim dhe duke pranuar të metat që keni, do arrini të ulni mbrojtjen e tij. Mos hezitoni të blini diçka për veten tuaj.

**DEMI**  
Disa mosmarrëveshje për çështje interesante, sidoqoftë humori juaj pozitiv do ju ndihmojë të shprehni ide të shkëlqyera në sektorin e punës dhe atë financiar. Situata është në zhvillim, por duhet të dini ta menaxhoni me metodën e duhur dhe shumë qetësi.

**BINJAKET**  
Një ditë shumë aktive nga e cila mund të merrni energji për punën dhe jetën në çift. Do keni shumë mundësi që nuk duhet t'i lini pas dore. Edhe pse nuk ju dhurojnë asgjë, rezultatet më të mira do t'i arrihi në fushën profesionale.

**GAFORJA**  
Mbani nën kontroll krenarinë tuaj dhe duhet ta pranoi që nganjëherë prekeni shpejt. Më në fund do arrini të përfundoni diçka me sukses, madje duke i lejuar vetes ndonjë shpenzim të vogël. Nuk është momenti të ndërmerrni projekte ambicioze. Duhet të kufizoheni me detyrat e përditshme.

**LUANI**  
Lajme të shkëlqyera për ata që kanë një çështje ligjore në dorë. Elemente të reja janë në favor të një zgjidhjeje që është e dobishme për interesat tuaja. Problemet me partnerin nuk janë zgjidhur akoma, por falë humorit të duhur jeni drejt fazës së sqarimit.

**VIRGJERESHA**  
Pranoni qetësisht një konfrontim opinionesh. Vazhdoni me idetë tuaja, edhe pse ju duken më të avancuara se të tjerëve. Raportet me të tjerët krijojnë tensione? Ndoshta pretendoni shumë. Mbani një gjendje shpirtërore të qetë.

**PESHORJA**  
Falë aftësisë për t'u përshatur dhe pak oportunizëm, do arrini më të mirën nga ndryshimet aktuale në fushën profesionale. Është dita e duhur që të bëni një vesh shurdh ndaj atyre që përpiqen t'ju bindin për diçka që keni kohë që jeni kundër.

**AKREPI**  
Dashuria ju rezervon surpriza të këndshme dhe mund t'ju ndryshojë jetën nëse arrini të lini pas dore dyshimet dhe qëndrimet provokuese. Mos i rezistoni asnjëherë së rinovimit që ndikon në sferën emocionale.

**SHIGJETARI**  
Hëna ekuilibron emocionet dhe ju vë në linjë. Nën shoqërinë e miqve tuaj do gjeni vetveten. Komunikimi i këndshëm në ambientin tuaj. Një çështje ligjore e ndërlikuar do kthehet në favorin tuaj.

**BRICJAPI**  
Ndonjë vështrësi është e parashikueshme sot. Mos hiqni dorë nga projektet tuaja, pikërisht tani që janë drejt përfundimit. Një rënie e përkohshme në vendosmërinë tuaj nuk duhet t'ju shqetësojë. Gjendje shpirtërore kontradiktore.

**UJORI**  
Të favorizuar nga Hëna keni kartat e duhura për të marrë vlerësimin e duhur nga kolegët tuaj. Raporte të shkëlqyera me të dashurin tuaj dhe dialog të hapur me miqtë. Ditë ideale për blerje.

**PESHQIT**  
Shmangni antagonizmat në vendin e punës; më në fund po vijen momentet që të mbledhni sukseset e merituar. Një udhëtim me familjen. Një periudhë reflektimi mund të sjellë rezultate të mira në marrëdhënien në çift.

# Katovica

## Kurthi i "formulës ukrainase" për Kosovën në OKB

(Vijon nga faqja e parë)

Nga SHABAN MURATI

Bisedimet midis Serbisë dhe Kosovës nuk po bëhen për të hyrë në OKB, por që të përfundojnë në një marrëveshje apo traktat të njohjes reciproke midis dy shteteve.

... për anëtarësim dhe që është njohja e Kosovës. Plani konsiston në atë që Serbia t'i ofrojë Kosovës anëtarësimin në OKB, por pa e njohur Kosovën si shtet. Në shkëmbim, Kosova duhet të ndihmojë Serbinë të anëtarësohet në BE, duke hequr dorë nga kërkesa e njohjes së Kosovës. Ky do të ishte sipas Beogradit thelbi i asaj, që po cilësohet si marrëveshje përfundimtare midis Serbisë dhe Kosovës. "Kosova mund të marrë vendin në OKB vetëm nëpërmjet marrëveshjes me Serbinë dhe Serbia duhet të marrë diçka", deklaroi në datën 5 dhjetor presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiç. Kur Sonja Biserko, presidente e Komitetit të Helsinkit të Serbisë, e pyeti se çfarë është kjo "diçka", Vuçiç tha se nuk dëshiron të flasë tani, por do ta bëjë nga marsi ose prilli. Sipas burimit diplomatik, që përmendëm në fillim të analizës, kjo "diçka" është heqja dorë e Kosovës nga njohja prej Serbisë në shkëmbim të lejes serbe për të marrë një karrige në OKB.

Plani diplomatik serb ka nisur të diskutohet në disa qarqe të mbyllura diplomatike europiane dhe diplomacia serbe është në fazën e sigurimit të mbështetjes nga shtete të BE për këtë plan të saj. Burimi diplomatik përdimor nga Beograd bën, gjithashtu, të ditur se plani serb është konsultuar paraprakisht me Moskën dhe ka siguruar miratimin rus, sepse pa votën e Rusisë në Këshillin e Sigurimit në OKB nuk mund të hapet rruga e anëtarësimit të Kosovës në OKB, ashtu siç është veto ruse pengesa kryesore e anëtarësimit të Kosovës në OKB.

Në disa qarqe diplomatike kanë shfaqur interesim për këtë plan të diplomacisë serbe "për të ofruar anëtarësimin në OKB pa pranuar njohjen e Kosovës si shtet", sepse është shtuar lodhja e Brukselit përballë një problemi të madh dhe të vështirë, siç janë marrëdhëniet midis Serbisë dhe Kosovës, dhe do të shpëtojë një orë e më parë nga ky telash.

Çështja kryesore është se si do të jetë qëndrimi diplomatik dhe strategjik, që do të përcaktojë Kosova ndaj këtij plani serb. Diplomacia dhe institucionet e nëndeshme serbe, që kanë lidhje okulte me strukturën të ndryshme në Kosovë, po përpiqen që në forma dhe rrugë të shumëllojta t'i krijojnë hapësirë pranimit të këtij plani serb në Prishtinë. Ka indikacione se në drejtim të këtij objektiv ata kanë arritur njëfarë suksesi, sepse në disa qarqe qeveritare në Prishtinë ka nisur të qarkullojë teza e habitshme se "Serbia nuk ka përse ta deklarojë se e njeh Kosovën", çka në një farë kuptimi mund të merret si një sinjal i pranimit indirekt të planit serb.

Në hartimin e planit të tyre qeveria dhe diplomacia e Serbisë duhet të jenë inkurajuar edhe nga qëndrimi tolerant, me tepër se sa duhet, i qeverisë së Kosovës, e cila në bisedimet e Brukselit me Serbinë sorolatet prej gjashtë vitësh në unazën e vogël të bisedimeve teknike dhe administrative. Nuk është bërë asnjëherë e qartë se sa vite duhet të kalojnë për të dalë në trasenë e vërtetë të bisedimeve politike për legalizimin e statusit të bisedimeve si bisedime midis dy shteteve dhe në finalizimin e qëllimit të natyreshëm për njohjen e shtetit të pavarur të Kosovës. Qeveria dhe diplomacia e Serbisë janë inkurajuar edhe nga



qëndrimi tolerant i qeverisë së Kosovës, e cila nuk ka reaguuar asnjëherë në tryezën e bisedimeve për situatën absurde, kur çdo ditë qeveria dhe diplomacia e Serbisë vrapojnë nëpër botë për të penguar njohjen e Kosovës. Beogradit shkel çdo ditë marrëveshjen e famshme të "normalizimit të marrëdhënieve" me Kosovën të 19 prillit 2013,

Përshtypja e krijuar nga diplomatët, që i ndjekin prej vitësh raportet midis Serbisë dhe Kosovës, është se nga bisedimet midis dy shteteve me ndërmjetësimin e BE, pala që ka fituar më shumë është Serbia. Serbia siguroi nëpërmjet këtyre bisedimeve dhe kërkesave teknike të Kosovës, alibin e madhe për "qetësimin e marrëdhënieve", gjë që i hapri rrugën asaj për marrjen e statusit të shtetit kandidat në BE dhe për hapjen e bisedimeve të pranimit me BE-në.

Tani jemi në një fazë të re, kur Serbia po avancon në hapjen njeri pas tjetrit të kapitujve të Traktatit të pranimit në BE dhe kur, siç deklaroi presidenti Vuçiç në 5 dhjetor, ajo parashikon që në vitin 2022 të bëhet anëtare e plotë e BE. Por për këtë ka një kusht të

madh, që quhet kushti i kushteve, që Serbia dhe Kosova të njohin njëra-tjetrën. Pikërisht në këtë klimë, pra me afrimin e datës kur kushti i kushteve do të ngrihet në fund të tratativave të pranimit midis BE dhe Serbisë, qeveria serbe harton planin e saj të fshehtë të ofertës për Kosovën që të anëtarësohet në OKB, por të heqë kërkesën e njohjes si shtet nga Serbia.

Kosova duhet ta ketë të qartë se nga njohja e Serbisë si shtet i pavarur ajo do të shkojë tek anëtarësimi në OKB, por nga anëtarësimi në OKB nuk mund të shkojë dot te njohja e saj prej Serbisë.

Përballë këtij plani të rafinuar diplomatik serb, Kosova duhet të tregojë një syçeltësi të jashtëzakonshme dhe të mos bëjë as indulgjenca të nxituara dhe as hapa, që i shkojnë lojës së Serbisë. Oferta serbe për Kosovën në OKB pa e njohur Kosovën si shtet është një kurth serb kundër pavarësisë, sovranitetit dhe integritetit shtetëror të Kosovës. Çfarë do të thotë konkretisht një ofertë e tillë dhe a duhet ta pranohet Kosova? Së pari duhet thënë se Kosova duhet të peshojë nga pikëpamja strategjike prioritetin se çfarë i duhet asaj më shumë: anëtarësimi në OKB apo njohja si shtet i pavarur nga Serbia.

Përgjigja, që dikton interesi kombëtar i sigurisë, i stabilitetit dhe i subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës, është se Kosova i duhet më përpara që të njihet nga Serbia si shtet i pavarur, gjë që do të thotë që Serbia të heqë dorë nga rivendikimet koloniale mbi Kosovën, të cilat i ka shkruar edhe në Kushtetutën e saj. Kosova duhet ta ketë të qartë se nga njohja e Serbisë si shtet i pavarur ajo do të shkojë tek anëtarësimi në OKB, por nga anëtarësimi në OKB nuk mund të shkojë dot te njohja e saj prej Serbisë.

Formula e qeverisë serbe me planin e ri për t'i ofruar Kosovës anëtarësimin në OKB, por pa e njohur atë, është, në fakt, një formulë dinake, që unë do ta quaja "formula ukrainase". Formula ukrainase është që një entitet bëhet anëtar i OKB, pa u njohur si shtet i pavarur dhe duke pasur statusin e të qenit pjesë e një shteti tjetër. Njësoj siç u bë Ukraina anëtare e OKB në vitin 1945 dhe ishte pjesë e një shteti tjetër, e Bashkimit Sovjetik. Pra, anëtarësia në OKB nuk i dha Ukrainës statusin e shtetit të pavarur dhe as të njohur ndërkombëtarisht si subjekt i pavarur i së drejtës ndërkombëtare. Askush nuk vendosi marrëdhënie diplomatike me Ukrainën deri në vitin 1991, kur pas prishjes së Bashkimit Sovjetik, ajo u bë shtet vërtet i pavarur. Pikërisht këtu qëndron thelbi i dinakërisë bizantine të qeverisë dhe të diplomacisë serbe. Duke ofruar Kosovës anëtarësimin në OKB, ata jo vetëm nuk e njohin Kosovën si shtet, por sanksionojnë të drejtën ta konsiderojnë pjesë të Serbisë, njësoj si Bashkimi Sovjetik dikur Ukrainën.

Institucionet qeveritare të Kosovës duhet të jenë tepër të vëmendshme dhe të mos hutohen nga joshja prej karrigës në OKB. Kina, një fuqi e madhe, mbeti 22 vjet jashtë radhëve të OKB. Ka edhe një element tjetër të rëndësishëm për t'u marrë në konsideratë. Anëtarësimin në OKB Kosovës mund t'ia japë Rusia, duke hequr veton si anëtare e KS të OKB, dhe jo Serbia, sepse po desh Rusia, Kosova hyn në OKB edhe pa lejen e Serbisë. Por nuk desh Rusia, Kosova nuk hyn në OKB edhe sikur të dojë Serbia. Pra, Serbia po kërkon të shesë diçka, që në fund të fundit nuk është kompetencë e saj. Nuk besoj se Rusia do të futet në një pazar të vogël ballkanik për sytë e bukur të Serbisë. Po të vijë puna deri futja e Kosovës në OKB, Rusia do t'i kërkojë Perëndimit diçka të madhe miballkanike, që ka lidhje me Krimenën, me Abzhazinë apo Osetinë e Jugut.

Problemet e mprehta të kërcënimit për sigurinë dhe sovranitetin e Kosovës vijnë nga Serbia dhe jo nga OKB. Ato probleme nuk i zgjidh OKB-ja. Ndaj Kosova duhet të jetë e qartë dhe e ftohtë që bisedimet midis Serbisë dhe Kosovës nuk po bëhen për të hyrë në OKB, por që të përfundojnë në një marrëveshje apo traktat të njohjes reciproke midis dy shteteve. Anëtarësimi në OKB është objektiv pas sanksionimit të njohjes së Kosovës nga Serbia, sepse njohja mbyll zyrtarisht dhe juridikisht çdo rivendikim serb ndaj saj.

Është tepër e rëndësishme që Kosova në kanale diplomatike të hedhë poshtë planin serb të "formulës ukrainase" dhe t'i bëjë të qartë Serbisë, por edhe BE-së, se Kosova nuk do t'ia japë Serbisë alibin e re të OKB. Zgjidhja e vetme për normalizimin e marrëdhënieve është respektimi i kushtit të kushteve, që është njohja e Kosovës nga Serbia.

**L**uftëtari fiton në fushën ku asnjë ekip nuk kishte mundur të siguronte 3 pikët. Kamza e çudirave kësaj radhe është ndalur në shtëpinë e saj, ndërsa skuadra e Ramadan Ndreut ka pësuar humbjen e tretë në kampionat. Por meritë absolute kanë të besuarit e Hasan Likës, që arrinjë suksesin "in ekstremit"



### Ekipi i Ndreut bie për herë të parë në shtëpi

## Luftëtari pushton "kalanë" e kamzalinjve

falë golit të Rrocës. Takimi është i luftuar, me gjirokastritë që këmbëngulin më shumë, por që edhe në këtë sfidë do të kenë pretendimet e tyre në lidhje me gjykimin. Dhe kanë të gjithë të drejtën me vete në minutën e 14-të, kur vetëm

Laver Alla nuk arrin të shohë 11-metërsh flagrant në favor të Rrocës. Më pas Bregu do të shkundë traversën, ndërsa në minutën e 33-të do të kemi një aksion të shpejtë të Abazajt nga e djathta, diagonalja e tij grushtohet me vesh-

tirësi nga Halilaj e më pas Rroca nuk e shtyn dot topin drejt rrjetës. Gjirokastritë edhe këtu pretendojnë për kontakt të parregull pas ndërhyrjes së Kuqit, por gjyqtari sinjalizon përsëri për vazhdimin e lojës. Megjithatë Luftëtari do të

shpërblehet atëherë kur Kamza nuk do të kishte më kohë të rikuperonte. Në minutën e 93-të dhe në zhvillimet e një këndoreje, një dalje e pasigurt e Halilajt i jep mundësinë Rrocës të gjuajë në portën e boshatisur dhe të shënojë golin e fitores, që i lejon bluzinjtë të ngjiten në renditje, duke lënë pas shpinë Villazninë.

Teuta shënon e para me Cmajcanin, por Trashi dhe Batha në të 94-ën, përmbysin rezultatin

# Partizani fiton në frymën e fundit

## Policia sherr me tifozët, ka të arrestuar



Jeton Selimi

**P**artizani vuan, por merr një nga ato fitore që të shijojnë aq shumë, si-domos kur vijnë në aksionin e fundit të ndeshjes. E kundërta duhet thënë për Teutën, që u përpoq mjaft për të dalë me pikë nga "Selman Stërmasi", por në fund u detyrua të kapitullonte. Ndeshja nis më mirë për Teutën, e cila pas një rasti të minutës së katërt me Amadu Latif, do të gjejë golin e epërsisë në minutën e 19-të. Atanda shpërqendrohet dhe Bilali gjuan fort nga jashtëzonës, çka e detyron Alban Hoxhën të grushtojë në vështrësi, me topin e mbetur në zonë, është mesfushori Cmajcanin që godet i pari duke ndëshkuar të kuqtë. Por Partizani reagon menjëherë dhe pa kaluar as 4 minuta, është Jasir Asani që jep një asist perfekt për Trashin dhe mesfushori nuk fal duke sjellë baraspeshën. Nga ky moment, Partizani bëhet më kërkuar në kërkim të fitores. Në të 36-ën të kuqtë kanë mundësi të artë për të kaluar në epërsi, Trashin harkon një top të bukur për Prognin, por ky i fundit nuk arrin të gjejë portën për fare pak. Sërish mesfushori provon në të 40-ën, por gjuajtja përfundon jashtë kuadrantit. Pjesa e parë mbyllet në barazim, ndërsa dhe e dyta do të flasë për të kuqtë. Në minutën e 60-të të besuarit e Starovës i shkojnë sërish pranë golit, kur Progni provon me një gjuajtje akrobatake në afërsi të pikës së penaltisë, por topi përfundon mbikkuadrat. Teuta ngacmon në minutën e 72-të dhe Hakaj, si ish, mund të kishte bërë dëme me gjuajtjen e tij, por Alban Hoxha ka reaguar mjaft mirë duke e dërguar topin në goditje këndi. Dy minuta më pas është sërish



Partizani që i afrohet golit me Filin, i cili ndalet në momentin e fundit nga mbrojtja e Teutës, që devijon topin në goditje nga këndi. Kur dukej se takimi do të mbyllej në barazim, në frymën e fundit të lojës, Asani depërton bukur nga krahu i majtë dhe jep një asist fantastik në qendër për kapitenin Batha, i cili me portë të boshatisur nuk fal, duke i dhënë ekipit

një trespikësh që e afrosh shumë me vendin e dytë që mbahet nga Flamurtari, pasi tashmë të kuqtë kanë 21 pikë, nga ana tjetër ka dëshpërim dhe mërzitje të Teuta, e cila nuk mundi dot të marrë një pikë, por edhe këtë javë mbetet në kuotën e 15 pikëve.

### SHERRI

Grupi i tifozëve të Partizanit, "Ultras Guerrils" ka bllokuar fillimin e ndeshjes



### MBROJTËSI

## Sakrifikoi për të qenë në fushë, Kalari përfundon në spital

Mbrojtësi i Partizanit ka pasur ethe dhe temperaturë të lartë dhe për këtë shkak u largua nga fusha në minutën e 55-të gjatë ndeshjes kundër Teutës. Pasi i la vendin Kotobellit, mbrojtësi i majtë i Partizanit u drejtua për në dhomat e zhveshjes dhe më pas drejt spitalit për shkak të temperaturës së lartë.

mes Partizanit dhe Teutës. Shkak është bërë përplasja e radhës e tyre me forcat e rendit. Mbështetësit e kuq, të cilët u konfliktuan me forcat e rendit një natë më parë para pallatit të sportit "Aslan Rusi", janë ndalur në hyrje të stadiumit, pasi u kërkohej karta e identitetit. Pas disa polemikave, disa prej tyre janë shoqëruar në komisariat. Ata që kanë mundur të futen në impiant, u kanë kërkuar lojtarëve të ndërhyjnë dhe kjo ka bllokuar

fillimin e takimit, derisa të vendosej se çfarë do të bëhej me mbështetësit që gjendeshin jashtë impiantit. Kapiteni i Partizanit, Batha, ka folur me tifozët dhe më pas me delegatin e ndeshjes, ndërsa edhe drejtori sportiv i Partizanit, Olsi Rama, është ulur në pistë për të sqaruar këtë situatë absurde. Pas 10 minutash ndërprerje, derisa lojtarët e Partizanit u siguruan që tifozët filluan të futeshin brenda, ndeshja filloi rregullisht.

### TRAJNERI I TEUTËS



**Magani:** Nuk do u kërkoj kurrë lojtarëve të shtrihen në fushë

**T**rajneri i Teutës, Gash Magani, beson se skuadra e tij duhet të fillojë të bëhet më e zgjuar në administrimin e situatave të lojës. Ai shpjegoi për "SuperSport" pas sfidës së ekipit tani duhet të mendonte si të mbyllte ndeshjet, gjë që nuk e kishte bërë deri më dje, edhe pse nuk do u kërkonte asnjëherë lojtarëve të vononin lojën me dashje. "I tillë është futbollit, nëse nuk je gjithmonë vigjilent ndëshkohesh, si ne. Sot (dje) kemi zhvilluar një ndeshje të mirë, por në fund mundëm, si shumë ndeshje. Ajo që më mërzit është se kam kaq muaj që drejtoj skuadrën dhe në çdo ndeshje pothuajse shënojmë, jemi të 2-3 skuadrat që shënojmë më shumë, por edhe kemi pësuar. Nuk mbajmë psikologjikisht, ishte gabim i ynë edhe të goli i parë. Kjo është diçka që i mbetet një analize tonën. Jam i mërzitur, sepse futbollit jo gjithmonë luhet drejt në Shqipëri. Lojtarët janë aktorë të menaxhimit të situatave. Unë nuk u kërkoj lojtarëve të rrezohen në fushë, nuk kam për ta bërë asnjëherë. Ne, edhe para se të pësonim golin, kishim momente ku mund ta ndëshkonim Partizanin dhe nuk e ndëshkuam. Bëmë ndërime për ta freskuar, skuadra u përgjigj, por në fund u mundëm dhe kjo me shqetëson disi", - tha Magani.

## Starova falënderon Zotin dhe konfirmon ardhjen e Telushit

### TRAJNERI I PARTIZANIT

**T**rajneri i Partizanit, Sulejman Starova, ka deklaruar se fitorja e djeshme, edhe pse e vuajtur, nuk ishte e pamerituar, pasi skuadra e tij kishte besuar deri në fund. Ndërsa në fjalët për TVSH e cilësoi si një dhuratë nga Zoti tripikëshin, Starova insistoi se ai erdhi me meritë. "Kur do, do! Donte sot dhe fituam ndeshjen. Nuk vodhëm gjë, kishim momente shumë të mira. Edhe kundërshtari nuk meritonte të dilte pa gjë, edhe pse nuk vodhëm gjë. Ishte ndeshje e bukur, fillimi e gjëti të papërgatitur skuadrën, nuk po fitonim duela, bënim kombinime. Pastaj skuadra ndryshoi për mirë. Pjesa e dytë ishte më mirë, kemi momente të mira e jo të mira. Ndryshimet kanë bërë punën e



vet, mungesa e Bardhit, vrozat, dëmtimet. Jemi të kënaqur që morëm një trespikësh me shumë vlera që na jep mundësinë të rekuper-

ojmë lojtarë të dëmtuar. Jam i lumtur se sot ishte ndeshje e fortë dhe si asnjëherë tjetër nuk kisha besim të madh duke parë gabimet individuale me shumicë. Kur skuadra luan mirë fillojnë gabimet, kur fillojnë ndryshimet, dëmtimet. Këto më bënë pesimist. Më vjen keq për kundërshtarin, nuk e meritonte të dilte pa pikë. Por besuam deri në fund dhe i shtuam sulmet pa mbarim në 15 minuta e fundit, Teuta e humbi ndeshjen se nuk ishte vigjilente derisa mbaroi loja. Morëm një trespikësh që duket sikur ishte i humbur, por Zoti deshi të na jepte dhe

duhet të përfitojmë nga kjo dhuratë që na dha Zoti për të punuar më qetë për të ardhmen. Objektiva tona deri tani ishin të qarta, e thamë që objektivi për ne është se fillon kampionati tani. Ne na filloi në fazën e dytë. Të bëjmë hyzmetin, duke punuar mirë, pastaj shohim kundërshtarët, le të themi që është një javë pozitive për ne. Presidenti Demi ka ambicie që të ketë skuadrën në elitë. Si ky Partizan, si ai më parë, ne gjithmonë luftojmë për lojtarë cilësorë, kemi ambicie për një skuadër kompetitive, ndaj ju them se kemi firmosur me Telushin. Shpresojmë të mbyllim këtë vit me rezultate pozitive, kanë mbetur tre ndeshje dhe kemi kohë për të menduar për këtë", - tha Starova.

TRAJNERI I SKËNDERBEUT



Ilir Daja është shprehur pas ndeshjes në Laç, ku pësoi humbjen e parë në kampionat, se ka shumë rezerva për lojtarët e sulmit, për altruizmin e munguar. Ai theksoi se nuk ishte i kënaqur me lojën e Xhejmsit: "Kemi bërë një pjesë të parë shumë të mirë, me shumë raste të mira për shënim, por gabuam në finalizim dhe nuk u treguam altruistë. Këtu kam rezervat e mia për lojtarët e sulmit, pasi duhet të pasonin më shumë për njëri-tjetrin.

Daja e kap me Xhejmsin: Kam rezerva për lojën e sulmit

Kishim dhe mungesa në këtë ndeshje, po ashtu nuk kishim shumë energji. Nuk është në etikën e klubit tonë të justifikohet, ndaj dhe dua të merrem me atë që bëjmë gabim në këtë ndeshje. Ajo që ishte më negative për ne në këtë ndeshje ishte finalizimi dhe pasimi për njëri-tjetrin. Nimaga nuk ish-

te në gjendjen e tij më të mirë, pasi u kthyer dje nga Zvicra, ndaj menduam që Xhejms të vepronte në zona të vogla më mirë. Menduam t'i jepnim Nimagës pak "çlodhje". Kam rezerva për lojën e Xhejmsit sot, sepse ai nuk luajti në ndeshjen e fundit në Europa League. Osmani ishte parash-

ikuar titullar në ndeshjen e sotme, por nuk ishte në gjendje të luante, ashtu si Radas dhe Dita. Do të vinte humbjen e parë, por erdhi në momentin që nuk duhej. Sot donim fitoren. Jam i mendimit se nuk duhet ta bëjmë dramë, në futboll ka edhe humbje. Rikthimi i kontingjentit do të na bëjë të jemi në gjendjen e duhur në vazhdim", - tha mes të tjerash për "Supersport" trajneri i Skënderbeut, Ilir Daja.

Ndeshje e fortë, korçarët dominojnë, vendësit shënuan ende pa dalë mirë nga dhomat e zhveshjes

Jeton Selimi

Pas 14-të javësh kampi onat Skënderbeu bie më në fund në Kurbin. Laçi i shkakton korçarëve humbjen e parë sezonale në një ndeshje ku i sfiduan si të barabartë. Dy ekipet dhuruan një futboll të hapur dhe me shumë raste për shënim, në fund ai që bëri diferencën ishte një perlë e Myrto Uzuni që i dhuroi Laçit një tre pikësh të artë. Skënderbeu zbrit me një aksion të shpejtë në krahuin e majtë. Gavazaj depërton mirë në zonë në minutën e gjashtë, krosin në qendër, por në momentin e fundit Sefgjinj devijon në kënditje këndi. Një minutë më pas ishte radha e Micit të krosonte nga krahu i majtë, Muzaka i vetëm në qendër të mbrojtjes kthen me kokë, por goditja e mesfushorit ishte qendrore dhe e lehtë. Laçi zgjedh të shpejtë minutash lojë ku Kallaku ngacmon Orges Shehin me një goditje nga distanca. Shtatë minuta më pas Rexhinaldo dhe Uzuni kombinon shumë bukur ndërmjet tyre me sulmuesin beratas që provoi menjëherë kuadratin, por Shehi tregohet pozicional duke larguar rrezikun nga

# Skënderbeu nuk "pushton" dot Laçin

Kryesuesit bien në Kurbin, i ndëshkon Uzuni



porta e tij. Aksioni i laçianëve nuk ka fund pasi ishte radha e Kallakut të gjuante në kuadrat, por sërish Shehi i ndal duke mbrojtur mirë shtyllën e parë.

Në të 21-ën kapiteni i korçarëve ndal çdo top që i shkon në kuadrat në çdo formë dhe largësi. Skënderbeu shpërdoron një mundësi të pastër në minutën e 35-të ku

Xhejms rrëmben një top pas gafës së Qaqit shërben për Gavazaj, por goditja e këtij të fundit ishte e gjitha për t'u harruar. Skënderbeu i shkon shumë pranë golit të avan-

tazhit në minutën e 42-të ku Muzaka i vetëm përballë portierit Selmani gjuan shumë keq. Në fundin e pjesës së parë korçarët zbresin në zonën e Laçit me një aksion model, por me këmbë Selmani mban në lojë bardhëinjte. Me fillimin e pjesës së dytë, në aksionin e parë, Myrto Uzuni me një aksion personal mposht më në fund Orges Shehin me një goditje shumë të bukur në limitet e zonës së rreptësisë. Laç merr zemër dhe është më i qetë në fazën sulmuese, në të 62-tën ishte Lushkja, që provoi me një goditje nga jashtë zonës, por topi përfundoi mbi transversë. Skënderbeu krijoi iluzionin e golit të barazimit

SUPERLIGA	
<b>TË SHUTUNËN</b>	
KUKESI-LUSHNJA	1-3
FLAMURTARI-VLLAZNIA	2-0
<b>TË DIELËN</b>	
LAÇI-SKËNDERBEU	1-0
KAMZA-LUFTETARI	0-1
PARTIZANI-TEUTA	2-1
<b>RENDITJA</b>	
SKËNDERBEU	31
FLAMURTARI	25
KAMZA	23
KUKESI	22
LACI	21
PARTIZANI	21
TEUTA	15
LUFTETARI	13
VLLAZNIA	12
LUSHNJA	8
<b>JAVA E 15</b>	
LUSHNJA-SKËNDERBEU	
VLLAZNIA-KAMZA	
FLAMURTARI-LACI	
LUFTETARI-PARTIZANI	
TEUTA-KUKESI	

me Lilajn në minutën e 81-të ku goditja e mesfushorit mori një trajektore të çuditshme duke lënë të pa lëvizur portierin Selmani, por për fatin e tij të mirë topi nuk përfundoi në kuadrat. Pavarësisht përpjekjeve të Skënderbet deri në fund, minutat e mbetura nuk sollën ndryshim në rezultat me Laçin që merr një fitore të madhe.

TRAJNERI I LAÇIT

## Mezani bën modestin: E gjetëm Skënderbeun të lodhur

Laçi është një nga surprizat më të mëdha në Superiore. Përveçse një ekip me lojtarë të rinj në organikë, Laçi po jep rezultate fantastike në Superiore. Këtë herë ekipi i Laçit i shkakton humbjen e parë në kampionat, kryesuesve të Skënderbeut. Trajneri Gentian Mezani në një intervistë për "Supersport", shprehet i lumtur për fitoren, por kërkoi të ulë euforinë e ekipit. "Kjo është ndeshja e tretë që fitoj kundër Skënderbeut. Kjo është skuadra më e mirë në kampionatin shqiptar dhe ka luajtur në Kupat e Europës. Padyshim që është një ekip për t'u vlerësuar, por përballë tij duhen ekipe që kërkojnë të guxojnë. Kryesuesit e Superiores mund të barazojnë apo edhe të humbin si ndaj nesh, vetëm nëse kundërshtarët e tjerë i zgjedhin këtë mënyrë loje. Sot (dje) kemi gjetur një Skënderbe të lodhur pa hequr meritat e skuadrës. Në pjesën e parë kemi rrezikuar disa, megjithatë mund të them që gjetëm një skuadër ndryshe nga ndeshja e shkuar. Por e përsëris që ekipi i Skënderbeut ishte paksa i lodhur në ndeshjen e sotme (djeshme)".



MBROJTËSI KUQEZI

## Tani e quajmë "stabilizatori", Mavraj: Të vazhdojmë të tregojmë pasion


Mërgim Mavraj po merr ndeshje pas ndeshje vlerësimit e mediave gjermane, pasi është kthyer në formën e tij më të mirë dhe po ndihmon Hamburgun të largohet nga zona e ftohtë e klasifikimit. Lideri i prapavijës tani ka marrë nofkën "stabilizatori" në mediat gjermane, ndërsa ai vetë insiston se është shumë e rëndësishme që skuadra ka ruajtur për tri ndeshje radhazi portën e paprekur. "Ishim superiorë, por nuk jam i zhgënjyer. E vlerësoj si një pikë ndaj një rivali. Megjithatë, ne kishim raste të pastra kurse Wolfsburgu as nuk kishte një goditje të rrezikshme në portë", tha ai për barazimin pa gola ndaj Wolfsburgut. Ne jemi kompakt në prapavijë dhe nuk lejojmë asgjë. Këto janë cilësi që na kanë ndihmuar edhe në sezonin e kaluar. Kemi dhuruar edhe një herë një luftë në lojë me pasion. Sipas mendimit tim, këto janë virtytet kryesore të skuadrës. Nga kjo ndeshje marr më shumë gjëra pozitive se negative. Duhet të vazhdojmë të tregojmë pasionin edhe në vijim. Në fund të sezonit, kjo pikë ndaj Wolfsburgut mund të ketë vlerën e arit për ne", deklaroi Mavraj.



PREMIER LIGA

## Siti fiton derbin ndaj Junajtids, Guardiola "vret" kampionatin

Derbi i Mançesterit i dhuron të gjithë, gola, spektakël, por në fund fitues del Siti, me rezultatin 2-1. "Qytetarët" dominojnë në pjesën e parë duke pasur mundësi të shumta shënimi, por portieri De Gea bën disa herë mrekullinë me pritjet e tij ndaj Sane dhe De Bryn. Junajtid reagon menjëherë duke gjetur vetëm pas dy minutash golin e barazimit në fundin e pjesës së parë. Fraksioni i dytë i ndeshjes nis sërish me dominimin e ekipit të Guardiols që gjen golin e avantazhit me Otamendin që përfiton falë një gabimi fatal të Lukakut brenda zonës. 6 minuta nga fundi i kohës së rregullit, portieri Ederson bën mrekullinë duke ndalur në dy raste Lukakun dhe Matën. Bernardo Silva në kohën shtesë humbet një shans të artë përballë De Geas. Pas kësaj fitoreje, Siti mban kreun e renditjes me 46 pikë, 11 më shumë se Junajtid. Ekipi i Guardiols vendos edhe një rekord me 14 fitore radhazi në kampionat.



Dje/në 'Deutsche Welle'

# Veprimtarët e të drejtave të njeriut - të kërcënuar

Gjithnjë e më shumë veprimtarë të të drejtave të njeriut e paguajnë angazhimin me jetën e tyre. Shumë kërcënohen dhe persekutohen. Ka vite që situata e të drejtave të njeriut në botë është në keqësim.

"Si mund t'u them fëmijëve ose nënës sime që gjithçka do të vejë mbarë? Ata e dinë që gënjej", -thotë një Mohamed Saree tepër i tensionuar në një intervistë me video në 23 maj 2017, në ditën para daljes në gjyq në Kairo. Avokatin egjiptian të të drejtave të njeriut e akuzojnë se ka dëmtuar emrin e vendit të tij dhe se paraqet një rrezik sigurie.

"Këto janë pika të aktakuzës që mund të më çojnë 25 vjet në burg", tregon Saree në intervistë. Në ditën tjetër, Saree-në e liruan pas pagesës së një garancie, por aktakuza mbetet. Si drejtues i zyrës së Institutit të Kairos për Studime të të Drejtave të njeriut ai kishte bashkëpunuar në 2014, në raportin nacional për gjendjen e të drejtave të njeriut në Egjipt.

## ÇMIME TË TË DREJTAVE TË NJERIUT SI MBROJTJE

Këtë vit, Mohamed Saree-së iu dha çmimi Martin-Ennals-Preis - një çmim, i cili njihet edhe si "Çmim-Nobel i të drejtave të njeriut". "Shpresojmë se vlerësimi publik do të kontribuojë që të hiqet dorë nga padija kundër Mohamed Saree-së", thotë Michael Khambatta, drejtor i Fondacionit Martin Ennals. Juria e fondacionit përbëhet nga anëtarë të dhjetë organizatave ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

## PUNA BËHET GJITHNJË E MË E VËSHITRË

"Në përgjithësi, situata e

"Si mund t'u them fëmijëve ose nënës sime që gjithçka do të vejë mbarë? Ata e dinë që gënjej", -thotë Mohamed Saree tepër i tensionuar në një intervistë me video në 23 maj 2017, në ditën para daljes në gjyq në Kairo. Avokatin egjiptian të të drejtave të njeriut e akuzojnë se ka dëmtuar emrin e vendit të tij dhe se paraqet një rrezik sigurie.



mbrojtësve të të drejtave të njeriut duket se po keqësohet", -thotë Khambatta në intervistë me DW. Në një raport, Amnesty Interna-

tional paralajmëron se puna e mbrojtësve të të drejtave të njeriut po keqësohet prej vitesh. Shumë zduken ose vriten - jo rrallë prej

qeverive të tyre, të cilat duhet të kishin detyrimin që t'i mbronin qytetarët e tyre. Për raportin "AI" ka folur me të afërm të vep-

rimtarëve të vrarë apo të zhdukur të të drejtave të njeriut. Shpesh, thotë raporti, viktimat e mëvonshme e dinin se rrezikonin jetën me punën e tyre.

Qofshin mbrojtës të ambientit, aktivistë të të drejtave të njeriut, avokatë, gazetarë e të tjerë: çmimi i luftimit të shkeljeve të të drejtave të njeriut është frikësueshëm i lartë. Në vitin 2016, në të gjithë botën u vranë 281 veprimtarë të të drejtave të njeriut, thotë Organisation Front Line Defenders. Kjo shifër është dyfishi i asaj të 2015-ës. Nuk ka shenja që këtë vit, numri të jetë më i vogël.

## POPULISTË TË RREZIKSHËM

Avancimi i politikanëve populistë në shumë vende të botës kontribuon në keqësimin e situatës së përgjithshme, thotë Kenneth Roth, drejtor ekzekutiv i Human Rights Watch.

"Të gjithë thonë se flasin për shumicën. Në shekullin e kaluar kishte disa qeveri fashiste dhe komuniste që pohonin se luftonin për shumicën, për ta shtypur pastaj popullin e tyre me mjetet më brutale të dhunës". Organizatat e të drejtave të njeriut kërkojnë nga ky shkak "Të bëhet e qartë se të drejtat e njeriut janë mjeti më i mirë kundër sundimtarëve të korruptuar dhe tiranikë", thotë Roth nga Human Rights Watch.

# BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.  
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,  
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE  
LAJMET E FUNDIT NE  
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET


KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com  
**BW**

ALAS



**Fjalëkryqi (1)**



VERTIKAL


- 1. Të çara ato të Shollohov.
- 5. Fillojë luftën.
- 6. Liszt kompozitor.
- 8. Marsi në Areopag.
- 9. Kështu fillon filmi.
- 11. Gjysmë linear.
- 12. Një freskues në tavan.
- 18. Eshhtë gazeta Panorama.
- 20. Mund të jenë kamikaze.
- 21. Masat pa kufij
- 23. Venier e spektaklit italian.
- 25. Sophia e kinemasë.
- 26. Safin tenist.
- 29. Eshhtë makut, i pangopur.
- 31. Eshhtë faqe ene.
- 32. Një kafshë që hap... galeri.
- 33. Një fytyrë e keqe.

- 35. Preken nga sindroma Basedow.
- 37. Italia në Internet.
- 38. Fillojnë vonë.
- 39. Krijoi James Bond.
- 40. Ishulli i Odiseut.
- 42. Van der portier.
- 43. Një karamelle aromatike.
- 44. Mund të shkojnë... nga frika.

VERTIKAL

- 1. Bëhet duke vënë në lojë.
- 2. Pak origjinale.
- 3. Thahet me bonifikim
- 4. Në fund djathtas.
- 5. Ishte Gjermania e Honecker-it.
- 7. Hidhet një për shesh.
- 9. Kokëkuaja në pit stop.
- 10. I famshëm ai i Sizifit.
- 12. Eshhtë në pikën më veriore e Shqipërisë.
- 13. Një diktator shtypës
- 14. Lëvizja Socialiste Spanjole.
- 15. I kanë çift radhët.
- 16. Janë llahtare.
- 17. Poeti kur nuk pi.
- 19. Fillojnë periudhën.
- 22. Omar që qe aktor.
- 24. Si sezonale.
- 25. Janë banorët në Riga.
- 26. Carey këngëtare.
- 27. Nuk i tregohen babait.
- 28. Bëjnë arte me re.
- 29. Kush ka... e ka hamburger toruan.
- 30. Një stacion orbital.
- 31. Fillojnë profesionin.
- 33. Gibernau i MotoGp.
- 34. I kanë të ndryshme tutat
- 36. Gjysmë ditari.
- 38. Varet me re.
- 41. Kufijtë e kujtesës.
- 42. Sapo fillonjë.

**Fjalëkryqi (2)**




HORIZONTAL

- 1. Gustav kompozitor.
- 6. Në krye të kryesisë.
- 7. Lexohet në pentagram.
- 11. Sastre aktore.
- 12. Gjysmë akordi.
- 15. Dhjetë angleze.
- 16. Satira për zë.
- 18. Eshhtë situata e tensionuar.
- 21. Pak teatrale.
- 22. Bëhet me mea culpa.
- 24. Fundi i një samurai.
- 25. Mbeten në fund.
- 26. Lind në kokë.
- 28. Në radhë të parë.
- 29. Iniciallet e Camus
- 30. Një vërë në Paris.
- 31. Partizani i vogël... në një film tonin.
- 33. Litra pa kufij.
- 35. Eshhtë fatë.


VERTIKAL

- 5. Fillojnë radhiten.
- 6. Janë kushte.
- 8. Tëtem pa ekstreme.
- 9. Mbyllin kanate.
- 10. Shqoqëronte Edipin e verbër.
- 13. Eshhtë gjeli.
- 14. Moore aktore.
- 17. Janë forcat e Reneas.
- 19. Janë përmasa.
- 20. Fund dhjetori.
- 23. Mbyllin dntaren.
- 26. Fillojnë matjet.
- 27. Duhën ruajturi.
- 32. I bën një serenatë Rosina-s.
- 34. Gjysmë rabin
- 38. Mustafa... Atatürk.
- 40. Të parat në Amsterdam.
- 42. Ai i muzave është Helikona.
- 45. Një pjesë e gadishullit
- 47. Muzika e Eminem.
- 49. Fillojnë operacionin.
- 50. Kapen të parat.
- 52. Kufijtë e drejtëzës.

**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

9	4		2			5			
8		3		6	9	2			
6			1				8		
	8	9		3				5	
	1	9		2		3			
2			1		7	6			
	9			7				4	
		5	6	4		8		7	
		7			8		1	2	

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

3	2	5	6	7	8	1	4	9	
4	7	8	1	5	9	3	6	2	
9	1	6	4	2	3	8	7	5	
2	4	9	8	6	7	5	3	1	
6	8	7	3	1	5	9	2	4	
1	5	3	9	4	2	6	8	7	
7	9	2	5	3	6	4	1	8	
5	6	1	2	8	4	7	9	3	
8	3	4	7	9	1	2	5	6	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Argëtim filozofik**

- Kujdesi shpie në përjetshmëri, moskujdesi në vdekje; të kujdesshmit nuk vdesin kurrë, të pakujdesshmit janë si të vdekur.
- Nëse doni të arrini ndriçimin, nuk duhet të studioni mësimet të panumërta. Thellohuni vetëm të njëra. Cila? Te dhembshuria e madhe. Kushdo që ka shumë dhembshuri, ka të gjitha cilësitë e Budës në pëllëmbën e dorës.
- Më mirë të jesh endacak e të udhëtosh vetëm, sesa të mykesh në shoqërinë e budallenjve.

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**

Përgjigja e numrit të djeshëm

12	6	10	2		15	10		15	1	11
1	9	3	7		8		2	7	16	11
4	1	10		5	3	9	3	8	2	12
2	9		16	6	4	2	8	6	9	2
18		12	1	15	2	8	1	11	2	7
6		11	1	15	9	1	8		1	1
4	3	1	9	3	8		11	16	8	2
2	7		9	3	2	4	3	8	2	16
	15	2	7			7	6	10	16	6
7	3	12	9	3	8		11		17	6
1	11	3		11	6	4	10	9	1	9
8	3	8		1	18	10	3	9	1	3

T	R	A	P	A	E	F	I	K	A	S
H	E	R	O	I	Z	M	I	P	A	K
E	K	T	P	A	P	A	T	L		
S	P	E	R	A	N	D	O	R	I	A
T	E	R	E	N	C	E	H	I	L	L
D	E	T	E	K	T	I	V	I	E	K
A	N	E	U	A	N	M	A	T	I	A
M	O									
A	R	R	I	E	A	H	I	E		
R	E	A	L	S	E	L	L	E	R	S
E	C	A	R	A	M	A	N	E	T	I
T	R	A	K	T	I	A	A	Z	I	L

**Thënie të mençura**

- Të të duan thellësisht - të jep forcë; të duash thellësisht - të jep guxim!
- Lao Tzu
- "Mik i mirë është ai që di gjithçka për ty dhe megjithatë vijon së qeni miku yt".
- Elbert Hubbard
- "Një mik i vërtetë është shumë e vështirë që të gjendet, shumë e vështirë që të largohet, dhe është e pamundur që të harrojë".
- I virtyshmi nuk mund të plagoset
- dhe dhimbja që tjerët duan t'i shkaktojnë, bie mbi vetë ato.
- Për të parë atë që pak njerëz kanë parë duhet të shkoni aty ku pak kanë qenë.

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVË TË NUMRIT TË KALUAR

A	M	O	K	A	K	F	E	S	T	A	T
F	A	R	U	K	S	H	Q	Y	T	A	R
T	L	V	A	I	E	A	N	A	M		
A	V	E	N	D	O	S	M	E	R	I	A
A	M	E	R	C	E	N	A	R	E	T	I
P	A	R	T	E	N	O	P	E	A	F	E
K	O	B	A	L	T	E	K	L	A	N	A
R	A	A	A	I	T	U	N	E	L	E	T
M	E	T	L	R	T	I	L	O	J	A	E
A	T	E	L	I	E	R	L	A	N	O	S
R	R	I	T	I	I	D	G	R	I		
S	P	O	R	T	I	S	T	E	P	A	R

FJALËKRYQI (1)



FJALËKRYQI (2)

K	U	P	A	D	A	S	M	A	T		
R	R	I	T	K	S	I	R	T	A	K	I
P	E	R	I	U	D	H	A	T	K	I	M
D	I	M	E	N	S	I	O	N	E	T	I
S	I	N	T	A	K	S	A	O	I	L	
T	E	T	O	R	T	L	T	R	E	A	
Z	A	R	A	R	E	A	S	I	R	E	T
N	D	L	S	T	K	O	R	R	J	A	O
A	L	A	T	R	A	V	T	A	T	A	R
T	A	L	B	O	T	I	A	A	A	T	
I	D	E	A	K	Y	G	S	T	U	F	A

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

# GAZETA SHQIPTARE

# GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

# GSH

www.gsh.al

## GAZETA SHQIPTARE



## Tashmë edhe lundroni!

